fije
balte

fije
balte
Rrugëtim i mjeshtërive
tradicionale në Kavajë

Funded by the European Union

fije balte

Rrugëtim i mjeshtërive tradicionale në Kavajë

Përgatitën për botim:
Irhan Jubica
Liridona Ura

Maj 2023

Ky botim është hartuar në kuadër të projektit "Rijetëzimi i zejeve tradicionale në Kavajë" me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Help dhe Fondacionit Gjirokastra dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian dhe/ose UNOPS.

Përmbajtja

Kujtesa e fijeve nga balta te realiteti virtual, *9*

Zhvillimi natyror i artit të punimit me dorë, *15*

Rritja cilësore e zejeve të reja dhe tradicionale, *27*
- Leshpunuesja, *29*
- Poçeria, *35*
- Qelqi, *45*

Rënia e beftë dhe të paepurit që nuk do të jenë të fundit, *61*
- Ligor Kostrista, *63*
- Ismete Shaba, *69*
- Myzejen dhe Luçie Hoxha, *73*
- Florida Gjergji, *79*
- Lulzime Krasnaj, *83*
- Myrvete Topi, *87*
- Suzana Istrefi, *91*
- Ferid Qarri, *95*

Arkeologjia industriale dhe punishtet si destinacione të turizmit të përvojës, *105*
- Ish-Fabrika e Qelqit, *105*
- Muzeu Etnografik, *115*
- Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, *119*
- Kostrista Ceramic Art, *125*
- End e thur, *131*

Burime, *135*

1. A është artizanati një pasion vetëm i brezit të tretë?



Kujtesa e fijeve nga balta te realiteti virtual

"Fije balte" është një përpjekje për të sjellë në vëmendje të kohës së sotme kontributin e traditës artizanale të Kavajës në mozaikun e kulturës popullore të vendit tonë. Qëllimi i kësaj nisëme sipërmarrjeje është krijimi i një lidhjeje të qëndrueshme mes trashëgimisë së pasur të së kaluarës dhe prirjeve bashkëkohore të arteve të aplikuara, nëpërmjet rritjes së krenarisë së artizanëve për atë çka përfaqësojnë. Libri synon t'i shërbejë nxitjes së një drejtimi të posaçëm të turizmit kulturor në zonë, duke i ndihmuar autoritetet lokale, udhërrëfyesit dhe operatorët turistikë, mediat, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të interesuar për këtë sektor – në paraqitjen e një oferte turistike serioze për Kavajën.

I konceptuar në formën e një historiku, punimi është mbështetur fillimisht në të dhëna dytësore - përmes burimeve të larmishme të periudhave që trajton, si dokumente arkivore, studime, skica, harta, libra e media të shkruara dhe audiovizuale. Ndërsa të dhënat parësore janë siguruar drejtpërdrejt në terren përmes metodave dokumentuese si intervistat, bisedat dhe pyetësorët e posaçëm me artizanë, specialistë dhe qytetarë të Kavajës,

matjet, fotografimi, intervistat, bisedat dhe pyetësorët e posaçëm me artizanë, specialistë dhe qytetarë të Kavajës. Organizimi dhe përpunimi i të dhënave në këtë rend është përcaktuar nga natyra kronologjike e një hulumtimi të tillë i ndarë në 3 periudha: para Luftës së Dytë Botërore (LDB), 1945-1990 dhe artizanati sot. E studiuar më parë nga etnografët, periudha nga lashtësia deri pas LDB është trajtuar shkurtimisht në studim, ndërsa theksi është vënë në periudhën nga pas LDB deri në ditët e sotme. Për shkak të zhvillimit cilësor që pësoi artizanati në Kavajë gjatë viteve të regjimit totalitar deri në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, kjo periudhë është trajtuar më vete. Ndërsa zbehja graduale e artizanatit kavajas deri në kuotat më të ulëta në dekadat 2000-2020 dhe nismat e kohëve të fundit për ta ringritur atë janë trajtuar gjithashtu si një periudhë e veçantë. Përmes identifikimit të zejeve, artizanëve, historive të tyre njerëzore dhe profesionale mbi punishtet dhe produktet, është arritur të hartohet një material i konsiderueshëm në funksion të paraqitjes me sa më me vërtetësi të

gjendjes aktuale të artizanatit në Kavajën e sotme. Në këtë mënyrë, bashkë me brezin që do të materializojë prirjet e reja me zejet e së kaluarës, rritet edhe besimi se e ardhmja e artizanatit mund të bëhet më e sigurtë nga motivimi i njerëzve dhe ekspozimi i tyre ndaj realiteteve të ngjashme në vende të tjera. Prandaj pjesëmarrja e artizanëve në panaire dhe ekspozita brenda dhe jashtë vendit është po aq e domosdoshme sa turet me vizitorë vendas e të huaj në punishtet e tyre. Në secilin rast, secila palë do të kete ç'të shkëmbejë nga fijet e padukshme që lidhin një marrëdhënie kaq të lashtë dashurie dhe respekti sa kjo e njeriut me artin e punës së dorës.

Për të përmbledhur me dy fjalë traditën e teknikave të shumta, si endja e qilimave, sixhadeve e mbulesave, thurja dhe qendisja e veshjeve dhe mjaft objekteve me fije materialesh të ndryshme - dhe atë të qeramikës me baltë – ky punim u titullua "Fije balte". Sikurse mjaft botime për qytete të tjera me traditë, le të shpresojmë se edhe ky libër do të jetë një gjurmë në përpjekjen e përbashkët për rikthimin e Kavajës në hartën e artizanatit shqiptar.

TIMELINE

Zhvillimi natyror i artit të punimit me dorë

Kavaja përmendet për herë të parë në shekullin XV, ndonëse gjetjet arkeologjike e datojnë vendbanimin që në prehistori[1]. Më pas qyteti është vendqëndrim i udhëtarëve lindorë[2] e perëndimorë[3] që sa vijnë e shtohen. Njëherësh, Kavaja evidentohet si një nga qendrat e njohura për zejtarinë e metalit, baltës, endjes, arkave të drurit e plot "*xhinglave*" të tjera[4], fillimi i të cilave është i pamundur të datohet në kohë[5]. Mirëpo për shkak të kapaciteteve profesionale modeste të zejtarëve të patrajnuar, prodhimet e artizanatit shqiptar nuk mund të konsideroheshin industri në vitet '20[6], e madje as në fund të viteve '30 të shekullit të kaluar, sepse ajo që quhej industri kufizohej te artizanati[7]. Deri atëherë shqiptari "*ka ba punë veç sa per me pshtue jeten*"[8]. Ndoshta për këtë arsye, Kongresi Arsimor i Tiranës i vitit 1922[9] vendosi të përfshinte në programin mësimor lëndët që i kontribuonin rritjes së aftësive të përgjithshme në disa zeje: "*1) Të preme letrash; 2) Me shpikun sende mozaike, pa model, pa moster; 3) Kartoni; 4) Me lidhë libra; 5) Punë teli; 6) Punët e drrasës; 7) Punët e teneqes; 8) Punë balte dhe 9) Punë Alceje*"[10].

2

3

4



5

Krahas endjes, si në qendrat e mëdha të Shqipërisë së Mesme[11] poçeria ishte angazhim edhe i grave[12]. Më 1897, në zonën e Kavajës funksiononin 10 furra për pjekjen e tjegullave[13], ndërsa për prodhimin e enëve, artizanët ia kishin lehtësuar punën vetes, duke përdorur çarkun që rrotullohej me këmbë[14], ndryshe nga gjetkë ku të gjitha proceset kryheshin me dorë. Që në fund të shekullit XIX[15] e deri në çerekun e parë të shekullit XX, të pëlqyera për larminë, ngjyrat dhe glazurën[16], qeramika e prodhuar nga 17 familje kavajase[17] dominonte tregjet e Shqipërisë së Mesme[18]. Ndonëse përdornin tavolina dhe furra mjaft primitive[19], prodhimet e tyre ishin mjaft të larmishme, si poça, shtama[20] e sidomos katruva, të cilat edhe pse të ngjashme me trevat e tjera shqiptare, dallonin për format e tyre *"harmonike e të hjedhta"*[21] etj. Ndoshta kjo konkurrencë i ka shtyrë disa artizanë për kalimin në punishte për prodhimin e qeramikës në vitin 1936[22] e që u pasua nga të tjera[23], të cilat zgjatën deri pas LDB - kohë kur u shkrinë në Kooperativat e Artizanatit.

Si pasardhës të një prej popujve më të hershëm europianë që punuan hekurin[24], burrat vazhdonin të merreshin me punimin e metalit, kryesisht duke imituar enët e importuara nga Italia[25]. Kjo mjeshtëri e metalpunimit kufizohej me prodhimin e enëve të llamarinës për transportin e ushqimeve[26], por shquhej për zilet e bagëtive[27]. Mirëpo në Shqipërinë e LDB zejet e punimeve të metalit, përfshi hekurin, bakrin, argjendin, si dhe të qilimave kishin kapacitete të vogla prodhuese[28].

Ndryshe nga qeramika, të dhënat për punimin e qilimave në zonën e Kavajës janë relativisht më të pakëta. Endja me tezgjah apo vegë ka dominuar ditën e grave

2. Treva e Myzeqesë ishte një treg i vazhdueshëm për poçarët e Shqipërisë së Mesme.

3., 4. Deri në vitet `50 të shekullit XX, punishtja dhe dyqani i zejtarëve ishte në të njëjtin vend.

5. Shtama, katruva e të tjera enë balte në një magazinë zejtarësh në përfundim të LDB.

dhe vajzave shqiptare për shekuj[29]. Mënyra e jetesës, e ndikuar nga kultura lindore apo perëndimore, ka përcaktuar përdorimin e shtrojeve, ndërsa terreni përmes lëndës së parë kushtëzonte llojet e tyre[30]. Kështu, përveç qilimave me lesh dele ose dhie, shtrojet të tjera të rënda përdoreshin edhe për fjetje[31], përpunoheshin në zona malore. Ndërkohë që nuk kanë munguar edhe shtrojet e thjeshta me veshjet e dala jashtë përdorimit[32]. Si në periudhat para Revolucionit Industrial, leshi i deleve vazhdonte të lahej me dorë buzë lumejve[33]. Një përpjekje për të mekanizuar proceset e punës për qilimat u bë në Gjirokastër më 1928, por nuk zgjati shumë[34]. Prandaj në vitin 1938, vendi nisi të importonte fije leshi nga Italia[35], ndonëse dy dekada më herët, Shqipëria kishte eksportuar qilima[36], në të njëjtën kohë kur të kamurit pëlqenin qilimat e blerë në Manastir e gjetkë[37]. Ndërsa në Korçë *"lulëzonte industria e qilimave[38]"*, pjesa më e madhe e leshit që prodhonte vendi në ato vite ishte i destinuar për eksport, pasiqë prodhimet e qilimave të vendit nuk shquheshin për ndonjë vlerë të madhe[39].

Ndërsa, në zonat fushore përdorej material bimor: mëndafshi, liri, kërpi[40] ose gjenshtra. Me traditë që në mesjetën e vonë, i rekomanduar nga studiuesit vendas[41] e të huaj në fillim të shekullit XX[42], dhe i përjashtuar nga tatimi i "*të dhetave*", kultivimi i krimbit të mëndafshit ka qenë megjithatë kufizuar në zonën e Shkodrës[43], Elbasanit e Tiranës[44], por prodhimi ishte i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat vendase, prandaj në vitin 1929, Shqipëria importonte rreth 20744 kg produkte mëndafshi nga Italia[45]. Madje nuk munguan thirrjet për taksimin e lartë të kësaj kategorie importesh



"*luksit*" për të stimuluar prodhimin vendas të mëndafshit që sa vinte e ulej[46]. Nga ana tjetër, pambuku[47] dhe liri janë kultivuar me rendimente të ulëta që në fillim të shek. XX[48], por përpunimi i tyre deri në veshje është bërë në sasi thuajse të papërfillshme[49]. Kultivimi i gjenshtrës për qëllime industriale nisi në periudhën e pushtimit italian, bashkë me disa stabilimente për larjen e leshit në mënyrë të mekanizuar[50].

Përgjithësisht, në punimet artizanale, motivet janë të lidhura ngushtë me teknikën, pajisjen në dispozicion, materialet dhe ngjyrat. Para prezantimit të ngjyrave, e para prej të cilave ishte e kuqja[51], motivet realizoheshin përmes ndryshimit të materialeve ose/dhe ndryshimit të teknikës.

Tradicionalisht, në një pjesë të madhe të punimeve të qeramikës, drurit, metalit, qilimave dhe qendismave dominonte simetria e elementëve gjeometrikë, të cilët janë më autoktonë, e më pas e atyre florealë[52]. Megjithatë, elementë të tjerë të përdorur për zbukurimin e punimeve të artizanatit ishin edhe simbolet pagane, si dielli, ylli, kuçedra, gjarpëri, kalliri i grurit etj. Përgjatë shekujve këto elementë u përzien me elementë të besimeve fetare përkatëse të zejtarëve[53].

Edhe vendi ku zejtaria ushtrohej kishte gjithë rol përcaktues në elementët e përdorur për të dhënë një motiv të caktuar. Kështu, në qytete, ndikimi i kulturave të huaja ishte më i madh se në fshatra[54], por zejtarët dhe prodhimet e tyre ishin të pranishëm në krijimtarinë gojore të shqiptarëve[55], pavarësisht nëse ata jetonin në fshat apo në qytet.

Përkundër dëshmive për traditën e hershme të punimit të qilimave, në një prej veprave pioniere[56] për kulturën

6

7

8

9

populllore, për zonën e Kavajës dokumentohet vetëm përpunimi i pambukut. Megjithatë, pavarësisht materialit, dizajni i aplikuar vlerësohej si "*i bukur dhe i ndërlikuar*", e kjo vlente edhe për qilimat që nuk mungonin, sidomos në shtëpitë qytetase[57], sepse shqiptarëve nuk u kanë munguar shijet artistike[58].

Në punimet me tezgjah, motivet realizoheshin përmes ndryshimit të materialit, përdorimit të fijeve me trashësi të ndryshme, të teknikave të ndryshme, e me vonë përmes ngjyrave. Në shumicën e herëve, motivet janë kompozime të formave gjeometrike që shmangin versione komplekse të cilat kushëzohen nga pajisjet, e më rrallë ato floralet dhe zoomorfe[59].

Kështu, me këto punime të zejeve dhe teknikave të ndryshme, nga 20-30 Qershor 1931, në Tiranë u arrit të hapej ekspozita e parë e artizanatit[60] ku secila prefekturë përfaqësohej me produktet e saj më karakteristike e një tjetër më 1943[61], ndërsa që nga 1936 në Bari[62] e deri më 1942 në Romë, Shqipëria mori pjesë rregullisht në panairet dhe ekspozitat e hapura në Itali[63].

6. Mbështjellja e fijes me pajisje druri që vazhdojnë të përdoren edhe pas 80 vitesh.

7. Sikurse pë qendistarinë, edhe për qepjen me makinë organizoheshin kurse aftësimi për gratë dhe vajzat.

8. Një grup vajzash peshojnë thasë me lesh deleje, nga i cili do të bëhen veshjet e ushtarëve italianë në vitet e LDB.

9. Një grua në Shqipërinë e Mesme duke punuar në tezgjah në fillim të shek. XX.

Shënime dhe referenca:

1 Akademia e Shkencave e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
2 Evliya Çelebi, “Shqipëria 350 vjet më parë”, Tiranë, 2003
3 Victor Bérard, “La Turquie et l’hellénisme contemporain”, Paris 1897
4 Edward Lear, “Journal of a landscape painter in Albania”, London 1851
5 Francesco Bonasera, “Katrovat e Fushës së Kavajës”, në Revistën “Leka”, nr. 6, Qershor 1943
6 Albert Calmes, “The economic and financial situation of Albania”, Geneva 1922
7 Francesco Jacomoni Di San Savino, “La politica dell'Italia in Albania - Nelle testimonianze del Luogotenente del Re”, Bologna 1965
8 “E para Ekspozitë Artizanati në Tiranë e zhvillimi i pûnës në Shqypní” në revistën “Hylli i Dritës”, Nr. 7-8, Shkodër 1931
9 Engjell Zerdelia, “Kongresi Arsimor i Tiranës dhe rëndësia e tij”, në gazetën “Telegraf”, Tiranë 23 Korrik 2014
10 “Sistemi i rí shkolluer” në revistën “Hylli i Dritës”, Nr. 10, Shkodër 1922
11 Rudolf Rotheit, “Aus Albaniens Werdetagen”, Berlin 1914
12 Afërdita Onuzi, “Mjeshtëria shtëpiake e punimit të enëve prej balte”, në revistën “Etnografia shqiptare”, nr. X, Tiranë 1979
13 Zyhdi Shehi, “Kavaja: trajtesa historike”, Durrës, 2017
14 Afërdita Onuzi, “Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë (Korçë) dhe në qytetin e Kavajës”, në revistën “Etnografia shqiptare”, Nr. IX, Tiranë 1978
15 Karl Patsch, “Das Sandschak Berat in Albanien”, Wien, 1904
16 Afërdita Onuzi, “Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë (Korçë) dhe në qytetin e Kavajës”, në revistën “Etnografia shqiptare”, Nr. IX, Tiranë 1978
17 Miroslaw Kaucky, “Mittelalbanische Stadt- und Wirtschaftsbilder”, në revistën “Österreichische Monatsschrift für den Orient”, Nr. 1-6, Wien, Januar-Juni 1916
18 Ernest Nowack, “A Contribution to the Geography of Albania” në revistën “Geographical Review”, Nr. 4, London, October 1921
19 Karl Patsch, “Das Sandschak Berat in Albanien”, Wien, 1904
20 Gjergj Fishta, “Nji udhtim në Turkí të Ré”, në revistën “Hylli i Dritës”, Nr. 2, Shkodër 1932
21 Francesco Bonasera, “Katrovat e Fushës së Kavajës”, në Revistën “Leka”, nr. 6, Qershor 1943
22 Kavaja Lajme, Kavajë, 25 Tetor 2020 (https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=141186357725110&id=100935175083562)
23 “Annuario del Regno di Albania”, Milano 1940
24 Edith Durham, “Albania: Oldest and Quaintest of Balkan People”, në “Peoples of All Nations”, No. 1, London 1922
25 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
26 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
27 Friedrich Wallisch, “Neuland Albanien”, Stuttgart 1931
28 Giovanni Demaria, “Principi di economia albanese”, Padova 1941
29 R. Sokoli, “Characteristic carpets and coverings”, në revistën “New Albania”, Nr. 1, Tirana 1976

30 Rrok Zojzi, “Qilima shqiptarë”, 1964
31 Jacques Bourcart, "L'Albanie et les Albanais", Paris 1921
32 Rifat Hoxha, “Njerëz, karaktere, mbresa”, Durrës 2022
33 “Albania”, dokumentar nga Istituto Nazionale Luce, 1937
34 Rrok Zojzi (Universiteti Shtetëror i Tiranës), “Qilima shqiptarë”, 1964
35 Giovanni Demaria, “Principi di economia albanese", Padova 1941
36 Michele Craveri, “Albania. Il paese e le genti”, Milano 1939
37 Constantin N. Burileanu, “Romeni di Albania”, Bologna 1912
38 Michele Craveri, “Albania. Il paese e le genti”, Milano 1939
39 Filippo Tajani, “L'avvenire dell'Albania", Milano 1932
40 Giovanni Demaria, “Principi di economia albanese", Padova 1941
41 Ismail Haxhihyseni, “Këshilla mbi të vumen e mëndafshit”, Elbasan 1921
42 Jacques Bourcart, "L'Albanie et les Albanais", Paris 1921
43 “Krymi i mndashit", Shkodër 1924
44 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
45 Giovanni Demaria, “Principi di economia albanese", Padova 1941
46 ti, “Burrimet e rrnesës shqyptare", në revistën “Hylli i Dritës", Nr. 3, Shkodër 1933
47 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
48 Giorgio Dal Piaz, Antonio De Toni, Roberto Almagià, “Relazione della Commissione per lo studio dell'Albania", Roma 1915
49 Josef Maria Kadlec, “Dnešní Albanie", Praze 1926
50 Gualtiero Mazzei, “Albania industriale", në Rivista “Albania", Nr. 5, Roma, Maggio XIX, 1941
51 State University of Tirana, “Albanian popular motives textiles and needlework", Tirana 1959
52 “Arti në Republikën popullore të Shqipërisë", Berlin 1953
53 Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, “Arti Popullor në Shqipëri", Tiranë 1976
54 “Arti në Republikën popullore të Shqipërisë", Berlin 1953
55 Franz Schnorr von Carolsfeld, “Archiv Fur Litteraturgeschichte" Vol. XII, Leipzig 1884
56 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
57 Edith Durham, “Albania: Oldest and Quaintest of Balkan People”, në “Peoples of All Nations”, No. 1, London 1922
58 Jacques Bourcart, "L'Albanie et les Albanais", Paris 1921
59 State University of Tirana, “Albanian popular motives textiles and needlework", Tirana 1959
60 “E para Ekspozitë Artizanati në Tiranë e zhvillimi i pûnës në Shqypní" në revistën “Hylli i Dritës", Nr. 7-8, Shkodër 1931
61 Roberta Belli Pasqua, Luigi Maria Caliò, Anna Bruna Menghini, “La presenza italiana in Albania tra il 1924 e il 1943", Roma 2017
62 “La giornata albanese alla Fiera del Levante di Bari", kinokronikë, Istituto Nazionale Luce, 1939
63 Roberta Belli Pasqua, Luigi Maria Caliò, Anna Bruna Menghini, “La presenza italiana in Albania tra il 1924 e il 1943", Roma 2017

10. Një punëtore e Fabrikës së Qelqit dhe Xhamit në Kavajë, 1971



Rritja cilësore e zejeve të reja dhe tradicionale

Pas LDB, shumica e zejeve në Shqipëri u zhvilluan në shkallë industriale. Qeramika, qelqi, druri e ndonjë tjetër në kuadër të industrisë së materialeve të ndërtimit[64], ndërsa endja, qendistaria etj në kuadër të industrisë së lehtë dhe artizanatit[65].

Baza e ndërmarrjeve shtetërore ishin Kooperativat e Artizanatit[66]. Të njohur dhe të promovuar edhe jashtë vendit[67] për mjeshtrinë e tyre, zejtarët u joshën për të hyrë në Kooperativat e Artizanatit edhe përmes mbështetjes së fuqishme me kredi[68] nga shteti, sepse synimi i këtij aksioni politik – shtetëzimi i pronës - ishte aq i rëndësishëm sa të studiohej nga ideologët e kohës[69].

Sikurse në të gjithë vendin, Kooperativa e Artizanatit[70] të Kavajës ishte pjesë e Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit[71] të themeluar më 1946, menjëherë pas krijimit të Kooperativës së parë të Leshpunuesve në Korçë, me detyrë organizimin e të gjithë zejtarëve në Koopertiva Artizanati, një proces i cili u finalizua në vitin 1961 dhe zgjati si i tillë deri më 1969[72], kur këto forma organizimi u transformuan në ndërmarrje shtetërore. Në raport me të kaluarën, por edhe me numrin e popullsisë, Kavaja ishte ndër qytetet më të industrializuara në vend, me Leshpunuesen, Poçerinë, Zdrukthtarinë, NTLAP, Gozhdë-Bulonat, Letrën, Konservat, Qelq-Xhamin etj.



Leshpunuesja

Fillimisht Kooperativa e Leshpunuesve[73] të Kavajës prodhonte vetëm veshje të leshta tradicionale, por me kalimin e viteve, punonjësve iu mundësua kualifikim dhe specializim në qytetet me traditë për qilimat e sixhadet (Shkodër, Korçë etj), dhe ata u rritën profesionalisht[74] sa filluan prodhimin, për herë të parë në vend, të qilimave "*të njëcopëta*"[75]. Mirëpo ndryshe nga prodhimet e qelqit e të qeramikës, qilimat e Kavajës nuk u renditën krah qilimave të trevave të tjera të Shqipërisë[76] në edicionin e vitit 1964[77] të botimit special "Qilima shqiptarë", ndërsa motivet e punëve me gjilpërë të zonës së Kavajës kishin zënë vendin e vet në katalogun e qendismave shqiptare.[78] Këto punime vinin nga një traditë ndoshta më e lashtë se qilimat dhe sixhadet, por që nuk u masivizuan në shkallë industriale. Ato përfaqësoheshin nga veshje, mbulesa funksionale dhe dekorative etj. Mjeti kryesor dhe i vetëm i përdorur për këtë teknikë ka qenë gjilpëra, ndërsa më vonë, fillimisht në qytete nisi përdorimi i mjeteve lehtësuese prej druri në formë katrore dhe një tjetër në formë rrethore e cila

11. Pamje e brendshme e njërit nga katër repartet e Ndërmarrjes së Qilimave (Leshpunueses) Kavajë, 1977.

12



13

14

15

mbahet në dorë gjatë punës. Ky ishte gjergjefi. Së bashku me teknikën e qendisjes, kjo teknologji mundësonte edhe realizimin e punimeve realiste, si peizazhet[79] etj. Figura të tilla si peizazhet dhe porteret u realizuan edhe në sixhadeve – sikurse ajo me portretin e Leninit – e prodhuar "*nga punonjësit e artizanatit Kavajë*", e që iu dhurua udhëheqësit sovjetik *Ники́та Хрушёв* (Nikita Hrushov)[80] me rastin e vizitës 12-ditore në Shqipëri[81]. Sixhadet dhe qilimat e Kavajës ishin të destinuara kryesisht për tregun e jashtëm, prej nga nuk u raportua ndonjë ankesë[82]. Prandaj brenda më shumë se një dekade, ishin Vlora dhe Kruja ata që prodhonin qilima si të Kavajës[83], ndërsa Korça vazhdonte të kryesonte në cilësinë dhe estetikën e qilimave të prodhuara në vend[84]. Mirëpo edhe për arsyet e cekura më lart, Ndërmarrja e Qilimave Kavajë ishte e pranishme në fjalimet e Enver Hoxhës[85], në kinokronikat[86] dhe shtypin propagandistik të kohës, ku cilësohej si "*one of the best known centers of the country where the rugs are manufacturated*"[87].

Për rëndësinë që kishte, Ndërmarrja e Prodhimit të Qilimave në Kavajë, në të cilën punonin me dy turne[88] në fillim

12. Kudrete Veizi Duka, Ndërmarrja e Qilimave, Kavajë, fundi i viteve 1970

13. Dy endëse të Ndërmarrjes së Qilimave Kavajë, 1977.

14. Pamje e njërit prej reparteve të Ndërmarrjes së Qilimave (Leshpunueses) Kavajë, 1990.

15. Ndërtesa kryesore e Ndërmarrjes së Qilimave Kavajë, 1980.

16

17

18

19

1200[89] e më pas 3000[90] gra dhe vajza[91], u vizitua edhe nga diktatorit i fundit komunist - Ramiz Alia më 1987[92]. Gjatë këtij turi katërditor ai u ndal edhe në Fabrikën e Qelqit ai u takua me të njëjtët punëtorë që kishin pritur paraardhësin e tij më 1971[93].

Ndërmarrja funksiononte me 4 reparte, tre nga të cilët prodhonin qilima me dy tipe tezgjahu (vertikal dhe horizontal), ndërsa tjetri prodhonte sixhade[94].

Ndërkaq në të gjithë vendin, në vitin 1990 kishte 12 ndërmarrje qilimash, por një vit më vonë funksiononin vetëm 2[95]. Gratë e këtij sektori përbënin 13% të forcës punëtore të grave, dhe afro 3% të fuqisë punëtore të Shqipërisë. Qilimat dhe sixhadet e prodhuara nga këto ndërmarrje siguronin eksporte me vlerë 5.8 milionë dollarë[96], që me llogaritjen e inflacionit sot mund të ishin afërsisht 13.3 milionë dollarë në vit[97].

Për disa vite, pjesë e kësaj ndërmarrjeje ishte edhe reparti i punimit artistik të bakrit, një linjë prodhimi e enëve dhe objekteve zbukuruese me bakër, e krijuar nga specialistët vendas[98]. Megjithatë, Ndërmarrja Artistike "Migjeni" e Tiranës shquhej për mjeshtrat e prodhimit të artikujve prej bakri[99], sikurse edhe për qilimat dhe prodhimet e tjera prej leshi[100].

16. Gjatë punës në Ndërmarrjen e Qilimave Kavajë, 1977.

17., 18. Endëset e Ndërmarrjes së Qilimave Kavajë ekspozojnë punimet e bëra me duart e tyre, 1972.

19. Pavioni Shqiptar në Panairin e Barit, Itali, 1977, ku ekspozoheshin edhe qilimat e prodhuar në Kavajë.

Poçeria

Për qeramikën dhe qelqin, qëllimi dhe drejtimi fillestar i industrisë ishte prodhimi në vend i materialeve të ndërtimit, si tulla, tjegulla, tuba kanalizimesh etj, por më pas gama e produkteve u zgjerua me tubat e drenazhimit, të kullimit, materialeve hidrosanitare, zjarrduruese etj. Këtij qëllimi i shërbeu mekanizimi i prodhimit[101] dhe ngritja e ndërmarrjeve, fabrikave dhe uzinave që mbanin një peshë të konsiderueshme të kësaj industrie në nivel kombëtar.
Në Tiranë, pjesë e kësaj industrie të re[102], Kooperativa e Poçerisë[103] u kthye më 1957 në Fabrikë Qeramikë-Qelqi[104] me ndihmën e Republikës Popullore të Polonisë[105]. Tre vjet më vonë, ajo u shndërrua në Ndërmarrjen Industriale Shtetërore të Qeramikës[106]. Ky vendim i Qeverisë u shoqërua me ndërjen e sektorëve[107], shpërndarjen e prodhimeve sipas parimeve të ekonomisë së centralizuar[108], e më pas decentralizimin e prodhimit të qeramikës së trashë[109], përmes hapjes së fabrikave të ngjashme në pothuajse çdo qytet të vendit, për plotësimin e nevojave lokale.
Një fabrikë e tillë u hap edhe në Kavajë. Poçeria e Kavajës

20. Furrat e pjekjes në Poçerinë e Kavajës.



21

22

23

24

lindi nga bashkimi i zejtarëve të vegjël[110], të cilës sipas botimeve të kohës, përbëheshin nga 3 mjeshtër e po aq ndihmës[111] që fillimisht prodhonte vetëm enë balte për nevojat e trevës përreth. Më pas, me futjen e tornove elektrike[112] u rrit gama e produkteve, sasia dhe cilësia e tyre. Duke qenë ndër fabrikat e para në vend, ajo zinte vend të rëndësishëm në raportimet për realizimin e prodhimeve të sektorit të poçerisë në nivel kombëtar[113], furnizimin e zonave rurale[114] me prodhime të poçerisë. Sikurse për çdo aktivitet tregtar në vend[115], shteti caktonte çmimet e shitjes me pakicë të prodhimeve të poçerisë[116] dhe sidomos të qelqit[117].

Si rezultat, deri në vitin 1973 prodhimi i qeramikës u rrit 10 herë[118], ndërsa në vitin 1974, në Shqipëri funksiononin 15 fabrika me kapacitet prej 252 milion copë tulla e tjegulla në vit[119] për mbulimin e nevojave të industrisë së ndërtimit në vend. Rritja e industrisë së materialeve të ndërtimit nga viti 1950 deri në vitin 1980 vlerësohej në 74.5 herë më shumë[120]. Madje futja në përdorim masiv e qeramikës në ndërtim, çoi në ngritjen e Uzinës së Materialeve Zjarrduruese në kuadër të Kombinatit Metalurgjik në Elbasan, e më vonë të Laboratorit të Qeramikës[121] në kuadër të Institutit të Studimeve të Teknologjisë së Ndërtimit. Në vitet e fundit të sistemit socialist, prodhimi i qeramikës dhe i qelqit, të marrë së bashku, vlerësohej në 142 milionë lekë[122], duke përbërë rreth 0.9% të sektorit të industrisë[123].

Mjeshtërve të kësaj industrie të re u mundësohej shkëmbimi dhe praktika pranë ndërmarrjeve më të mira të vendit[124], por edhe specializimi jashtë shtetit, kryesisht në vendet e Bllokut Komunist, nga Europa Juglindore deri në Lindjen e Largët[125]. Ndërsa punëtorët e rinj të qeramikës, qelqit,

21. Mjeshtri Zija Ilviu gjatë punës në Poçerinë e Kavajës, fundi i viteve '70 të shek. XX.

22. Një punëtore e Poçerisë së Kavajës, duke nxjerrë nga furra vazot e realizuara me argjilë të derdhur në kallëpe, 1974.

23. Rifiniturat e vazove pas heqjes së tyre nga kallëpi, sikurse edhe pikturimi i tyre, ishte një punë që në Poçerinë e Kavajës kryhej nga gratë dhe vajzat. 1974.

24. Punëtorë të Poçerisë Kavajë, ndër ta Konstandin Kostrista (i treti, në këmbë), në mesin e viteve '70 të shek. XX.

qilimave e më pas të bakrit, përpara punësimit në secilën ndërmarrje të artizanatit u ushtroheshin kurseve 3-6 mujore, ku profilizoheshin për vetëm një proces të caktuar pune[126]. Për pasojë, zgjerimi i kapaciteteve dhe i gamës së produkteve të industrive të qeramikës dhe të qelqit[127] u bë me materiale të vendit[128], që në Shqipëri nuk mungojnë[129] e që ishin studiuar që prej fillimit të shekullit XX[130]. Edhe më tej, në zonat përreth qytetit të Kavajës u studiuan shtresat e gips-alabastrës[131], të shfrytëzuara prej shekujsh nga mjeshtrat vendas, krahas "shkëmbimit" të lëndës së parë me artizanët e zonave të tjera – një marrëdhënie që vazhdon edhe sot.

Që nga shkollat e mesme[132] e deri në të lartën[133] arti i qeramikës u studiua në vazhdimësi[134].

Institucionet kërkimore-shkencore, që nisën të themeloheshin në vend[135], i kushtuan një vëmendje të konsiderueshme studimit të artit popullor[136], duke synuar modernizimin e tij brenda kornizave të kohës[137]. Produkte dhe dizenjo të reja nisën të realizoheshin nga institucionet e ngritura për këtë qëllim, në mesin e të cilëve edhe Sektori i Entografisë i Institutit të Historisë[138]. Me kohë, punimet e artizanatit zunë të dalloheshin për motivet patriotike[139],



të shprehura përmes simbolikave të shqiponjës, flamurit, ngjyrave të kuqe e të zezë etj. Pavarësisht se këto motive sot duket sikur vijnë nga shekujt, futja e tyre në artizanat ishte krejtësisht e orientuar nga ideologjia e sistemit totalitar, që synonte krijimin e një kulture të re popullore "*socialiste në përmbajtje dhe kombëtare në formë*"[140]. Shteti investoi masivisht dhe në çdo drejtim për krijimin, përhapjen dhe dokumentimin e kësaj kulture të re[141].

Këtij qëllimi i shërbyen krijimi i serive të prodhimeve tematike, në zeje të ndryshme, përfshi edhe qëndismat, qilimat dhe sixhadet. Elementë figurativë të stilizuar si ylli, pushka, drapëri etj, zunë të ishin gjithnjë e më shumë të pranishëm, ndërsa elementët e vjetër të zbukurimit u shtynë në cepat e punimeve, duke u përdorur si kornizim apo sfond i elementëve të rinj[142]. Në rastin e Kavajës, vlerat e këtyre prodhimeve të reja u evidentuan në një dokumentar të kohës[143], ndërsa motivet e punimeve të artizanatit në shkallë vendi frymëzuan hapjen e disa ekspozitave nga studiues dhe artistë të ndryshëm[144]. Me punimet e para të qeramikës dhe të qelqit të ndërmarrjeve të krijuara në Tiranë, Kavajë, Korçë etj, në vitin 1962 u hap një ekspozitë[145] kombëtare. Kështu, objektet e traditës zunë vend përkrah



objekteve bashkëkohore të prodhura nga artizanët e qeramikës e jo vetëm, në Muzeun Historik të Kavajës[146] - sot Muzeu Etnografik[147], i hapur në vitin 1971.
Tradicionalisht, punimet kavajase të qeramikës ishin enët e përmasave dhe llojeve të ndryshme, format e të cilave janë vlerësuar si klasike, të ndikuara nga qeramika e lashtë[148]. Duke krahasuar imazhet e regjistruara nga studiuesit në verën e vitit 1916[149], vërehet se disa objekte të poçerisë së trashë kanë mbijetuar, ndërsa disa të tjera, si enët konike (*xhauni*[150]), saçi (*ponica*[151]), amforat klasike të verës etj. prodhohen gjithnjë e më rrallë. Një arsye për humbjen e disa prej tyre është ndërrimi i kulturës së jetesës, natyrisht i përcaktuar nga zhvillimi ekonomik.
Kështu, përgjatë viteve, punimet e qeramikës së Kavajës[152] u ngritën nga stadi i artizanatit në nivelin e qeramikës artistike[153] - çka meritoi vend në faqet e para të albumeve për krijimtarinë popullore[154]. Kjo arritje ishte rezultat i kërkesës së vazhdueshme për standarde më të larta estetike dhe teknike në të gjitha prodhimet e artizanatit[155]. Për këtë qëllim në Poçerinë e Kavajës që në vitin 1973 u hapën dy linja të reja: e qeramikës artistike dhe e gurit[156]. Rezultati i këtij kujdesi të shtuar për artin e qeramikës shihet në

21. Enë dheu të prodhuara në Poçerinë e Kavajës, pjesë e koleksionit të produkteve artizanale shqiptare në albumin "Arti popullor në Shqipëri", 1976.

26

27

28



29

"Katalog 1979" të Ndërmarrjes së Prodhimeve Qeramike Kajavë. Në 32 faqet e këtij katalogu me 29 fotografi me ngjyra, janë paraqitur rreth 145 produkte të larmishme – shumica dekorative. 22 punime janë prej guri alabastër, të gdhendura në repartin përkatës të kësaj Ndërmarrjeje, ndërsa pjesa tjetër i përket qeramikës artistike të derdhur me forma e të realizuara me dizenjo e ngjyra të ndryshme, ku dominojnë ato të tokës, si dhe glazura me shkëlqim të fortë[157]. Megjithatë, studiuesit e artit jo gjithmonë ishin të kënaqur me nivelin estetik të produkteve të qeramikës artistike[158].

Ndërkohë, në Vlorë, krahas objekteve dekorative me derdhje[159], prodhohej kryesisht poçeria e trashë ose terrakotat e pikturura[160], e po ashtu edhe në Fabrikën e Korçës, ndërsa prodhimet e Tiranës promovoheshin si më të realizuara artistikisht[161] dhe të një game më të gjerë, me servise dekorative, medalione etj. Përfshirja gjerësisht e qeramikës si element dekorativ në arkitekturë në vitet 1980[162], çoi në ngritjen e Ndërmarrjes së Materialeve Dekorative të Ndërtimit[163] në Kavajë në vitin 1987.

26. Enë uji e një prej formave tradicionale e që ende vazhdon të prodhohet në Kavajë.

27. Produkte qeramike të Poçerisë Kavajë, 1974.

28. Frutierë guri, 1974.

29. Vazo guri, prodhuar në repartin e posaçëm të Poçerisë Kavajë, 1979.

Qelqi

Projektideja për ndërtimin e Fabrikës së Qelq Xhamit në Kavajë u diskutua mbledhjet e Qeverisë që në vitin 1965[164]. Baza e projektit teknik ishte hartuar nga kinezët, ndërsa arkitekti Kostaq Sahatçi i Institutit Shtetëror të Projektimit bëri përshtatjet e nevojshme[165]. Edhe puna për ndërtimin e asaj[166] që u njoh si krenaritë e Planit të Katërt 5-vjeçar[167] (1966-1970), u krye me ndihmën e specialistëve kinezë[168] përgjatë viteve 1968-1970[169], të cilët u angazhuan edhe më tej[170], si drejtues teknikë[171] deri më 1978[172].

Fabrika u përurua në prani të udhëheqjes politike[173] të kohës në 28 Nëntor 1970[174]. Kapaciteti fillestar i saj pritej të ishte 1.5 milion m^2 xham[175] dhe rreth 5000 ton qelqurina[176] në vit. Plani i Pestë 5-vjeçar parashikonte rritjen e industrisë së qelqit dhe qeramikës në masën 140-144% në krahasim me vitin 1970[177]. Përveç linjave të prodhimit teknologjik të xhamit të zakontë e të pasqyrave, të qelqit optik[178] e të pajisjeve laboratorike[179] etj., Fabrika e Kavajës kishte edhe reparte për realizimin e enëve dhe objekteve të zbukurimit në mënyrë artizanale[180]. Në vitin 1971 prodhonte 8

30. Pavarësisht automatizimit të punës në Fabrikën e Qelq-Xhamit, Kavajë, disa produkte si vazot, kupat dekorative etj, kalonin në procese të mirëfillta artizanati. 1975.

31



32

33

34

artikuj[181], më 1977 rreth 100 artikuj të ndryshëm prej qelqi, përfshi dhe 4 lloje lentesh për prohektorët[182], ndërsa më 1984 arritën në 150[183]. Në vitin 1978 u bënë përpjekjet e para për prodhimin e xhamit të temperuar[184], ndërsa 3 vjet më vonë, kronikat e kohës dëshmojnë arritjen e kësaj ambicjeje[185] deri në prodhimin e izoluesve elektrikë prej qelqi të temperuar. Kërkimet për të mbështetur industrinë e qelqit çuan në zbulimin e rezervave të mëdha të kuarcit në Shishtavec[186] e gjetkë. Zbulimi i burimeve me lëndë të para shtoi prodhimin[187], prandaj zgjerimi i Fabrikës, i projektuar nga i njëjti arkitekt që në vitin 1972[188], u bë brenda Planit të Gjashtë 5-vjeçar[189] (1976-1980).

Nga 864 punëtorët[190] e fillimit, ky numër u dyfishua brenda dekadës së parë dhe gati 600 prej tyre ishin gra dhe vajza[191]. Ndërsa në të gjithë Kavajën, më 1984, gratë përbënin 44% të forcës punëtore[192].

Rëndësinë politike, por edhe sociale të industrisë së re kavajase në emancipimin e grave[193] përmes punësimit të tyre në jo vetëm në Fabrikën e Qelqit, por edhe në Leshpunuese, Poçeri, NTLAP, Letër, Konserva etj., e dëshmojnë shkrimet propagandistike[194] në media[195] dhe

31. Fabrika e Qelq-Xhamit në Kavajë gjatë ndërtimit, 1969.

32. Ceremonia e përurimit të Fabrikës së Qelq-Xhamit në Kavajë, 28 Nëntor 1970.

33. Vizitë e delegacionit të punëtorëve kinezë në Fabrikën e Qelq-Xhamit Kavajë, Prill 1972.

34. Pamje e ansamblit të Fabrikës së Qelq-Xhamit Kavajë, mesi i viteve ‘80 të shek XX.

35



36

37

38

arte[196], si pikturë, skulpturë e kinematografi[197], por edhe në fushën e studimeve[198]. Ky aksion politik i kërkuar nga vetë Enver Hoxha[199] angazhoi artistët lokalë e më gjerë[200] në krijime të shumta, ndër më të njohurat e të cilave është edhe kënga për punonjëset e Fabrikës së Qelqit, kënduar nga grupi muzikor i Shtëpisë së Kulturës Kavajë[201]. Vetëm gjatë vitit 1970, mbi 50 grupe amatore të Kavajës konkurruan në festivalin lokal, ndërsa me këngët më të mira u botua antologjia "*Zemra e popullit këndon*"[202]. Një ansambël folklorik më vete kishin gratë dhe vajzat e Ndërmarrjes së Qilimave në Kavajë, e koncerti i tyre i parë u dha në Dhjetor të vitit 1972[203].

Në këtë mënyrë ishte arritur ajo që 40 vjet më parë konsiderohej si "*jo e lehtë*" [204] për një vend *krejtësisht oriental*[205].

Prandaj vetëm 6 muaj pas hapjes, më 6 Prill 1971[206], Fabrika u vizitua nga udhëheqësi i atëhershëm Enver Hoxha[207], ndërkohë që reportazhet pozitive[208] nisën të shfaqeshin në të gjithë vendin.

Fabrika e Qelqit Kavajë[209], me ekspozitën e përhershme[210] të hapur në mjediset e saj, u kthye brenda një kohe të shkurtër

35. Enver Hoxha mes punëtorëve të Fabrikës së Qelqit në Kavajë, Prill 1971.

36. Fryerja e automatizuar dhe vendosja në kallëp e qelqit të shkrirë në Fabrikën e Qelq-Xhamit Kavajë, 1971.

37. Teknologjia kineze e Fabrikës së Qelq-Xhamit Kavajë (1971), manovrohej edhe nga gratë.

38. Gratë dhe vajzat ishin forca e vetme punëtore në reparte si ky i gdhendjes së objekteve të qelqit në Fabrikën e Qelq-Xhamit Kavajë, 1975.

39



40



41



42

në destinacionin kryesor të vizitave të udhëheqësve, artistëve[211] apo vizitorëve nga vendet e tjera në Shqipëri. Ndërkohë që në kuadër të Ekspozitës "Shqipëria sot"[212], punimet e qeramikës, qelqit, qilimave, metalit, drurit etj, kishin pavionet e veçanta, ose të përbashkëta[213], e po ashtu në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në ekspozita[214] dhe panaire ndërkombëtare[215].

Në këtë mënyrë, 10 vjet përpara hyrjes në mijëvjeçarin e ri, Kavaja përjetoi jo vetëm ringjalljen, por ngritjen në stadin e saj më të lartë të krijimtarisë artistike në disa zeje, si qeramikë, qilima e metalpunues, ndërsa punimet në qelq ishin për qytetin një traditë e shtuar, por që do të zhdukej brenda 2-3 viteve, si të mos kishte ekzistuar kurrë.

39., 40., 41., 42. Produkte të ndryshme qelqi të piktuara dhe të gdhenura në Fabrikën e Qelq-Xhamit, Kavajë, mesi i viteve '70 të shek. XX.

Shënime dhe referenca:

64 Direktivat e Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë “Mbi Planin e Dytë Pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë viteve 1956-1960” 2 Qershor 1956, në “PPSH Dokumenta kryesore, Vëllimi II, 1949 - 1956”, Tiranë 1972
65 Instituti i Studimive Marksiste-Leniniste, “Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve» 25 Dhjetor 1953, në “PPSH Dokumenta kryesore, Vëllimi II, 1949 - 1956”, Tiranë 1972
66 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
67 “Tourist Guide book of Albania 1969”, Tirana 1969
68 Beqir Meta (recenzent), Adriana Meko (redaktore), “Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri”, Tiranë 2003
69 Kadri Dingu, “Lufta e PPSH për transformimin socialist të zejtarëve për zhvillimin e Kooperativave të Artizanatit dhe shndërrimin e prones së tyre në pronë të të gjithë popullit”, Tiranë, 1979
70 Këshilli i Ministrave, “Relacioni i Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit, shqyrtuar në Kryesinë e Këshillit të Ministrave datë 29.03.1956, mbi dhënien e disa kapanoneve Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit Kavajë për transferimin e Fabrikës së Litarit nga Rrogozhina", Dosja nr. 197, Tiranë 1956
71 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
72 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
73 Rrok Zojzi (Universiteti Shtetëror i Tiranës), “Qilima shqiptarë”, Tiranë 1964
74 Rifat Hoxha, “Njerëz, karaktere, mbresa”, Durrës 2022
75 Rrok Zojzi (Universiteti Shtetëror i Tiranës), “Qilima shqiptarë”, Tiranë 1964
76 Universiteti Shtetëror i Tiranës, “Qilima Shqiptarë”, Tiranë 1964
77 Andromaqi Gjergji, “Bibliografi e etnografisë shqiptare 1944-1979", Tiranë 2021
78 State University of Tirana, “Albanian Popular Motives Textiles and Needlework”, Tirana 1959
79 State University of Tirana, “Albanian popular motives textiles and needlework”, Tirana 1959
80 Sonja Llana, “Histori/ Kavajë, 1959. Sixhade me profilin e V.I. Leninit”, në gazetën “Bulevard", Durrës, 31 Tetor 2020
81 Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, “Inventari i Dokumentacionit i Vitit 1959”
82 “Woven works of art", në revistën “New Albania”, Nr. 3, Tirana 1977
83 “Woven works of art", në revistën “New Albania”, Nr. 3, Tirana 1977
84 “Culture people's heritage", Tirana 1973
85 Enver Hoxha, “Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë", Tiranë, 20 Dhjetor 1974
86 G. Dhrimaj, “Delegacioni i punëtorëve Kinezë në vendin tonë", Kinostudio “Shqipëria e Re", Tiranë 1972
87 “The Albanian carpets” në revistën “New Albania”, Nr.1, Tirana 1972
88 Rifat Hoxha, “Njerëz, karaktere, mbresa”, Durrës 2022
89 “The Albanian Woman - a great force of the revolution", Tirana 1978
90 Mitro Çela, “Rrënjët e Kavajës", në Gazeta “Fjala”, Tiranë, 24 Qershor 2020
91 “Kinokronika Nr. 13", kinostudio “Shqipëria e Re", Tiranë 1975
92 Ramiz Alia, “Fjalime e biseda Qershor-Dhjetor 1987", Tiranë, 1988
93 Moikom Zeqo, “Durrësi mikpritës, gjithë populli pjesëmarrës", në Gazetën “Drita", Tiranë, 14 Qershor 1987
94 Myzejen Hoxha, videointervistë, Kavajë, 4 Maj 2023
95 U.S. Agency for International Development, “Women in development”, Washington, 1993
96 U.S. Agency for International Development, “Women in development”, Washington, 1993
97 Inflation Calculator (https://www.in2013dollars.com/)
98 Rifat Hoxha, “Njerëz, karaktere, mbresa”, Durrës 2022
99 Ramadan Sokoli, “Coppersmith ëith Golden Hands”, në revistën “New Albania”, Nr. 6, Tirana 1970
100 Dhimo Gogollari, “Prodhime të tezgjahut tonë", në Gazetën “Drita”, Tiranë, 27 Qershor 1971
101 Këshilli i Ministrave, “Vendim i Këshillit të Ministrave dhe materiali përkatës, mbi mekanizimin e zdrukthtarisë dhe poçerive", Dosja nr. 680, Tiranë 1958
102 “Shqipëria - njohuri të përgjithëshme", Tiranë 1981

103 Këshilli i Ministrave, “Relacion dhe vendim i Këshillit të Ministrave mbi një shtesë në planin e investimeve të Kooperativës të Poçerisë në Tiranë për 3/mujorin e katërt të vitit 1952”, Dosja nr. 791, Tiranë 1952
104 Këshilli i Ministrave, “Relacion i Ministrisë së Industrisë e Minierave dhe vendimi përkatës për krijimin e Ndërmarrjes Industriale Shtetërore e Qeramikë-Qelqit në Tiranë”, Dosja nr. 601, Tiranë 1957
105 https://fototeka.arkiva.gov.al/public/file/21812-fotografi-e-fabrikes-se-qelqit-tirane-ndertuar-me-ndihmen-e-republikes-popullore-te-polonise
106 Këshilli i Ministrave, “Relacione të NISH Qeramikës dërguar Aparatit të Këshillit të Ministrave mbi zbatimin e eksperiencës Kineze”, Dosja nr. 672, Tiranë 1961
107 Këshilli i Ministrave, “Vendim i Këshillit të Ministrave dhe relacioni me projektvendimin përkatës, mbi ndarjen e Ndërmarrjes Industriale të Qelq-Qeramikës Tiranë” Dosja nr. 345, Tiranë 1960
108 Këshilli i Ministrave, “Korrespondencë e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave, Komisionit të Planit me Aparatin e Këshillit të Ministrave mbi prodhimin, planin e shpërndarjes të prodhimeve prej qelqi si dhe plani i masave për përmirësimin e punës në industrinë e qelqit dhe qeramikës.” Dosja nr. 751, Tiranë 1959
109 Këshilli i Ministrave, “Vendim i Këshillit të Ministrave, mbi heqjen e poçerisë së trashë, udhëzim mbi realizimin ritmik të planit të prodhimit të furnizimit të këtyre prodhimeve, si dhe relacion i Këshillit teknik të NISH qeramikës Tiranë, mbi variantet e ndërtimit të furrave në uzinën e porçelanit për pjekjen e prodhimeve dhe fonderisë artistike në Uzinën Enver.”, Dosja nr. 735, Tiranë 1962
110 Sheref S. Zenelaj, “Kujtesë. Kavaja në vitet 1930-1940 simbas kujtimeve të bashkëkohësve”, Kavajë 2000
111 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
112 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
113 Këshilli i Ministrave, “Relacioni me projektvendim të Komisionit të Planit të Shtetit, mbi shtimin e prodhimeve të poçerisë” Dosja nr. 317, Tiranë 1955
114 Këshilli i Ministrave, “Relacion dhe informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave dhe Komisionit të Kontrollit të Shtetit dhe procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, datë 30.08.1958, mbi prodhimin dhe furnizimin e tregtisë dhe kooperativave me artikuj mobilje, orendi, tulla, tjegulla e poçeri”, Dosja nr. 43, Tiranë 1958 dhe: Këshilli i Ministrave, “Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, datë 30.08.1958, raport, pasqyra dhe informacione, mbi prodhimin dhe furnizimin e tregtisë e kooperativave, me artikuj, mobilje, orendi, tulla, tjegulla e poçeri.”, Dosja nr. 644, Tiranë 1958
115 Ligj Nr. 5506, “Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 28 Dhjetor 1976
116 Këshilli i Ministrave, “Vendime të Këshillit të Ministrave Nr.438 e 439 mbi çmimet me pakicë të poçerisë dhe të grumbullimit të lirë të patates” Dosja nr. 460, Tiranë 1956
117 Këshilli i Ministrave, “Vendim i Këshillit të Ministrave, së bashku me relacionin e Ministrisë së Tregtisë dhe Aparatit të Këshillit të Ministrave, mbi zbritjen e çmimeve me pakicë të shisheve dhe kavanozave prej qelqi”, Dosja nr. 222, Tiranë 1968
118 Adil Çarçani, “Socialist Albania - country of new reality and of the new man”, në revistën “Albania Today”, Nr. 1, Tirana, Januar-February 1974
119 Piro Kono, Krenar Halimi, Faik Karapici, “Industria e material ndërtimit - prapavijë e shëndoshë e ndërtimeve të pesëvjeçarëve” në Revistën “Ndërtuesi”, Nr. 6 (41), Tiranë, Dhjetor 1974
120 Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, “Album për gjeografinë ekonomike të Shqipërisë”, Tiranë 1984
121 “Nëpër institutet tona studimore dhe projektuese”, në Revistën “Ndërtuesi”, Nr. 1 (86), Tiranë, Janar-Shkurt-Mars 1986
122 Drejtoria e Statistikës në Ministrinë e Ekonomisë, “Vjetari Statistikor i Shqipërisë, 1991”, Tiranë, 1991
123 Raymond E. Zickel, Walter R. Iwaskiw, “Albania, a country study”, Washington 1992
124 Kozeta Olldashi, “Students in Overalls”, në revistën “New Albania”, Nr. 1, Tirana 1971
125 Rifat Hoxha, “Njerëz, karaktere, mbresa”, Durrës 2022
126 Myzejen Hoxha, videointervistë, Kavajë, 4 Maj 2023
127 Fatos Tartari, “Enë qelqi të shekujve I-IV të e. sonë nga Shqipëria”, në revistën “Iliria” Nr. 1-2, Tiranë 1996
128 Këshilli i Ministrave, “Vendimi i Komisionit Shtetëror i Rezervave të Naftës e të Gazit dhe Mineraleve të tjera të dobishme ''Për miratimin e raportit gjeologjik të vendburimit të alabastrit gipsor në Mengaj (Kavajë) me llogaritje të rezervave me gjendje 31.07.1993'', si dhe relacioni përkatës”, Dosja nr. 546, Tiranë 01.21.1984 - 02.20.1984

129 Bashkim Lleshi, “Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë jo metalorë të Shqipërisë”, në gazetën “Rruga e Arbërit”, nr. 5 (189) Maj 2022
130 Jacques Bourcart, “Les confins albanais administrés par la France (1916-1920) : contribution à la géographie et à la géologie de l’Albanie moyenne”, Paris 1922
131 Savet Ohri, “Vendburimi i gips-alabastrit Gipsar-Mengaj”, në revistën “Buletini i Shkencave Gjeologjike”, Nr. 3, Tiranë 1985
132 Këshilli i Ministrave”, Relacion i Ministrisë së Arsimit e Kulturës mbi mbylljen e degës së qeramikës në Liceun Artistik me vendimin përkatës” Dosja nr. 297, Tiranë 1963
133 Elpiniqi Coja, “Në Institutin e Lartë të Arteve”, dokumentar nga Kinostudio “Shqiperia e Re”, Tiranë 1977
134 Afërdita Onuzi, “Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë (Korçë) dhe në qytetin e Kavajës”, në revistën “Etnografia Shqiptare”, nr. IX, Tiranë 1978
135 Instituti i Folklorit, i krijuar në vitin 1960, ishte baza e themelimit të Institutit të Kulturës Popullore në vitin 1979, bashkë me disa sektorë të fushës së studimeve entografike.
136 Andromaqi Gjergji, “Arti popullor shqiptar”, në revistën “Nëntori”, Nr. 8, Tiranë 1954
137 Fuat Dushku, “Mbi disa probleme të qeramikës së artizanatit dhe të qeramikës artistike”, në revistën “Nëntori”, Nr. 5, Tiranë 1964
138 Adriana Elini, Anxhelina Xharra, Fiqiri Haxhiu, “Qilimat tanë”, dokumentar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1975
139 Adriana Elini, Anxhelina Xharra, Fiqiri Haxhiu, “Qilimat tanë”, dokumentar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1975
140 Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, “Arti Popullor në Shqipëri”, Tiranë 1976
141 Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, “Arti Popullor në Shqipëri”, Tiranë 1976
142 Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, “Arti Popullor në Shqipëri”, Tiranë 1976
143 Adriana Elini, Anxhelina Xharra, Fiqiri Haxhiu, “Qilimat tanë”, dokumentar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1975
144 Sofokli Koci, “Motive të artit popullor shqiptar”, në revistën “Nëntori”, Nr. 3, Tiranë 1975
145 Xhanfize Keko, “Zhurnal Nr. 25”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1962
146 Hiqmet Myftiu, “Nëpër sallat e një muzeu të ri (Muzeu Historik i Kavajës)”, në gazetën “Bashkimi”, Tiranë, 25 Mars 1976
147 Muzeu Etnografik Kavajë “Muzeu Etnografik Kavajë”, Tiranë, 1982
148 Afërdita Onuzi, “Mjeshtëria shtëpiake e punimit të enëve prej balte”, në revistën “Etnografia shqiptare”, nr. X, Tiranë 1979
149 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
150 Arthur Haberlandt, “Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien”, Wien 1917
151 Afërdita Onuzi, “Mjeshtëria shtëpiake e punimit të enëve prej balte”, në revistën “Etnografia shqiptare”, nr. X, Tiranë 1979
152 A.Çela, “Kinokronika Nr. 9”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1974
153 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
154 Akademia e Shkencave e Republikës popullore Socialiste të Shqipërisë, “Arti Popullor në Shqipëri”, Tiranë 1976
155 Andon Kuqali, “Mbi artizantin artistik (vërejtje dhe propozime”, në revistën “Nëntori”, Nr. 5, Tiranë 1964
156 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
157 Ndërmarrja e Prodhimeve Qeramike Kavajë, “Katalog 1979”, Kavajë 1979
158 Ferid Hudhri, “Interesimi duhet të jetë më i madh edhe për gjinitë më të vogla”, në Gazetën “Drita”, Tiranë, 30 Mars 1980
159 Pleurat Sulo, “Krijime të bukura në qeramikë”, në Gazetën “Drita”, Tiranë, 11 Korrik 1971
160 http://www.zemrashqiptare.net/news/14460/luan-cipi-dashuri-e-nderprere.html?skeyword=a
161 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
162 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
163 Këshilli i Ministrave, “Procesverbali dhe vendimi i Kryesisë së Këshillit të Ministrave datë 27.10.1987, mbi krijimin e Ndërmarrjes së Materialeve Dekorative të Ndërtimit në qytetin e Kavajës, relacioni i Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ministrisë së Ndërtimit për këtë problem. 10.27.1987 - 11.05.1987”, Dosja nr. 263, Tiranë 1987
164 Këshilli i Ministrave, “Relacione, informacione, skica e korrespondencë të Ministrisë së Ndërtimit e Industrisë drejtuar aparatit të Këshillit të Ministrave, mbi ndërtimin e fabrikës së qelqit e të xhamit Kavajë”, Dosja nr. 804, Tiranë 1965
165 Gjergj Thomai, Fatlinda Struga, Oketa Boriçi, Nerxhana Tallushi, “Kavaja Zhvillimi urban 1945-1990”, Tiranë 2020
166 “Të reja nga Shqipëria Nr. 1”, Kinostudio Shqipëria e Re”, 1969; Ylli Pepo, “Kinoditari Nr. 2”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1969
167 Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, “Album për gjeografinë ekonomike të Shqipërisë”, Tiranë 1984
168 Rifat Hoxha, “Njerëz, karaktere, mbresa”, Durrës 2022
169 Irfan Veterniku, “Të njihemi me veprat tona: Fabrika e Qelqit”, në Revistën Ndërtuesi, Nr. 3 (8), Tiranë, Qershor 1969

170 G. Dhrimaj, “Delegacioni i punëtorëve Kinezë në vendin tonë”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1972
171 “Letter of the CC of the Party of Labour and the Government of Albania to the CC of the Communist Party and the Government of China”, në revistën “Albania Today”, Nr 4, Tirana 1978
172 Susan Warren, “China on Africa's Fight for Independence”, në “New China", Nr. 4, New York 1978
173 Halil Kamberi, “Kinoditari Nr. 47”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1970
174 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
175 M. Zeqo, “Kinoditari Nr. 12”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1968
176 Irfan Veterniku, “Të njihemi me veprat tona: Fabrika e Qelqit”, në Revistën Ndërtuesi, Nr. 3 (8), Tiranë, Qershor 1969
177 Mehmet Shehu, “Raport mbi direktivat e Kongresit të 6 të PPSH mbi Planin V 5-vjeçar”, Tiranë 1971
178 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Tiranë 1984
179 Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë 1985
180 Hamide Saraçi, “Industrializimi i Kavajës, aty ku prodhoheshin telat me gjemba", në Gazeta “Standard”, Nr. 2037, Tiranë, 27 Shtator 2011
181 Susan Warren, “China on Africa's Fight for Independence”, në “New China", Nr. 4, New York 1978
182 “Glass engraving", në revistën “New Albania", nr. 4, Tirana, 1977
183 Susan Warren, “China on Africa's Fight for Independence”, në “New China", Nr. 4, New York 1978
184 “Kinoditari Nr. 4”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1978
185 Ilia Dede, “Kinoditari Nr. 21”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1981
186 Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë, “Buletini Informativ”, Nr. 2, Tiranë 1970
187 Kristo Jorgji, Vangjush Furrxhi, “Kinokronika Nr. 3”, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1973
188 Gjergj Thomai, Fatlinda Struga, Oketa Boriçi, Nerxhana Tallushi, “Kavaja Zhvillimi urban 1945-1990”, Tiranë 2020
189 Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, “Album për gjeografinë ekonomike të Shqipërisë”, Tiranë 1984
190 Hamide Saraçi, “Industrializimi i Kavajës, aty ku prodhoheshin telat me gjemba", në Gazeta “Standard”, Nr. 2037, Tiranë, 27 Shtator, 2011
191 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
192 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
193 “Woven works of art”, në revistën “New Albania”, Nr. 3, Tirana 1977
194 Moikom Zeqo, “Durrësi mikpritës, gjithë populli pjesëmarrës”, në Gazetën “Drita”, Tiranë, 14 Qershor 1987
195 “The golden-handed fiery-hearted”, në “The Albanian woman - a great force of the revolution”, Tiranë 1978
196 Saimir Kumbaro, Nazmi Roli, Nexhati Tafa, “Fëmijët, qelqi dhe balta”, Tiranë 1974
197 Qerim Mata, Gjergj Vlashi, “Udhëtim në pranverë”, film artistik i Kinostudios “Shqipëria e Re”, Tiranë 1975
198 Stefanaq Pollo, “Probleme të luftës për emancipimin e plotë të gruas”, Tiranë 1969
199 Enver Hoxha, “Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë”, Tiranë, 20 Dhjetor 1974
200 Kujtim Gjonaj, Luan Rama, “Kur nis një këngë rinie”, dokumentar, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1975
201 Thabit Rexha, “Vajzat e Fabrikës së Qelqit (Kavajë)” në https://www.youtube.com/watch?v=mLpYXhpPGXk
202 Mustafa Beqiri, “Mbi 50 grupe amatore”, në Gazetën “Drita”, Tiranë, 20 Dhjetor 1970
203 “Kronikë kulturore”, në Gazetën “Drita”, Tiranë, 19 Nëntor 1972
204 Friedrich Wallisch, “Neuland Albanien”, Stuttgart 1931
205 Lovro Mihačević, “Po Albaniji”, Zagreb 1911
206 Muzeu Historik Kavajë, “Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit”, Durrës 1984
207 “Takime të gëzuara”, dokumentar, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1971
208 Luan Rama, Kinokronika Nr. 26, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1974,
209 Ilia Dede, Kristaq Dhamo, “Në udhët e reja të jetës”, dokumentar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1985
210 Luan Rama, “Kinokronika Nr. 26", Kinostudio “Shqipëra e Re”, Tiranë 1974
211 “Me ansamblin Rugova të Pejës”, “Motive Dibrane”, “Manifestimi shkelqyer i artit revolucionar Kinez. Ansambli Liaonin”, dokumentarë të realizuar nga Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1972
212 Bashkim Hoxha, Vitore Çeli, “Shqipëria sot”, dokumentar, Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë 1975
213 M. Kuteli, “Mbresa nga ekspozita Shqipëria socialiste në 20-vjetorin e saj”, në revistën “Nëntori”, Nr. 4, Tiranë 1965
214 Fuat Dushku, “Artizanati ynë në panairet ndërkombëtare”, në Gazetën “Drita”, Tiranë, 21 Qershor 1970
215 Sheri Baboçi, “Albania in International Fairs and Exhibitions”, në revistën “New Albania”, Nr. 6, Tirana 1970

43. Endje e qilimave të leshtë nga artizanënet kavajase në ditët e sotme, Prill 2023.

Rënia e beftë
dhe të paepurit që nuk do të jenë të fundit

Edhe pse qyteti vjen me këtë traditë të pasur të poçerisë, qilimave, qelqit etj, si dhe ka një rrugë të gjatë mbi 1 km me emrin "*Mjeshtrit e Qeramikës*", e një segment tjetër rrugor (rreth 75 m) që njihet si "*Rruga e Artizanëve*", në Planin e Përgjithshëm Vendor[216] dhe në Planin e Detajuar Vendor[217] të Kavajës nuk ka asnjë konsideratë për këto zeje: fjala "artizanat" përmendet vetëm dy herë, ndërsa "poçeri", "qeramikë", "metalpunim", "qilim", "qendisje" etj nuk gjenden në dokument. Zbehja e kësaj tradite pohohet edhe në dokumente të tjera të Bashkisë[218]. Artizanët kavajas nuk janë të pranishëm në Katalogët[219] "Made in Albania" të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Privatizimi që pasoi rënien e sistemit socialist u shoqërua me ngritjen e disa punishteve të vogla artizanati[220], duke çuar në mbylljen, braktisjen e më pas shkatërrimin e atyre që quheshin ndërmarrje shtetërore[221]. Përveç faktorit njeri, duket se edhe natyra luan rolin e saj në fatin e kësaj trashëgimie: Tërmeti i Shtatorit 2019[222] shkakoi jo pak dëme në objektet e qeramikës të ekspozuara në Muzeun Etnografik të Kavajës, megjithëse ato tashmë janë

Ligor Kostrista

Qëndrestari më i lumtur në mesin e artizanëve kavajas duhet të jetë bartësi i brezit të pestë të poçarëve, Ligor Kostrista, sepse zejen e tij po ia trashëgojnë edhe fëmijët, që mund të bëhen brezi i gjashtë – e më i vjetri ekzistues i poçarëve kavajas që e trashëgojnë këtë zanat.

Me një përvojë mbi 45-vjeçare, që prej vitit 1992, Ligori e ushtron aktivitetin në shtëpi. Babai i tij, Kostandini, tashmë 93-vjeçar, e ka marrë zanatin nga i ati, Zaku – e ai, nga i ati – Lluka, që gjithashtu e kishte të trashëguar zejen e poçarit[232] nga babai i tij, Zaku, pasiqë që nga viti 1880, veç poçarisë, familja e ka traditë trashëgueshmërinë e emrave nga gjyshi te nipi. Kostandini nuk e ka mbërritur gjyshin e tij, por kujton se i ati punonte si poçar në Elbasan dhe në Fier, ndërsa Ligori e mban mend qypin e punuar nga Zaku, e të gjetur në muret e shtëpisë së vjetër, në themelet e së cilës ai ndërtoi të renë, në kapërcyell të viteve 1990. Megjithatë, Ligori ruan ende një vazo të madhe të punuar nga Kostandini, ndërsa dy djemtë – i madhi që trashëgon emrin e gjyshit - Kostandini i ri dhe

44. Poçari Ligor Kostrista, duke krijuar kallëpin për një suvenir me peizazh të qytetit të Kavajës, Prill 2023.

45. Poçari Ligor Kostrista duke krijuar kallëp allçie për një pjatë dekorative. Prill 2023.

i vogli, Franko kanë plot objekte të krijuara nga babai i tyre. Disa prej këtyre objekteve ata do t'i ruajnë për t'ia bashkëngjitur historikut të familjes, krahas punimeve që tashmë kanë nisur t'i realizojnë me duart e tyre.
Energjinë e tij pozitive, Ligori e përcjell kryesisht në poçarinë e trashë, në vazot, shtamat, katruvat, tavat, pllakat, tasat, gotat, arkat e kursimit me torno dhe forma (shabllone), por edhe në objektet më të vogla me derdhje. Ai kujton se në kohën e Ndërmarrjes së Poçerisë, në repartin e teknikës me derdhje punonin kryesisht gra dhe vajza, sepse sipas tij, poçeria e trashë – tornoja dhe shablloni, duan krahë të fuqishëm dhe rezistencë[233].

46. Enë balte të prodhuara nga poçarët Kostrista.

Brezat e poçarëve Kostrista:
Zak Kostrista
Lluka Kostrista
Zak Kostrista
Kostandin Kostrista
Ligor Kostrista

Ismete Shaba

Një vlerë e shkollë më vete për zejen e punimit të qilimave tradicionalë në Kavajë është Ismete Shaba, 70-vjeçarja që vazhdon të endë në tezgjah. Prandaj edhe sipërmarrja e saj ësthë pagëzuar me ermin "End e thur". Sikurse mjaft artizanë të tjerë, edhe Ismetja ia ka trashëguar këtë zanat vajzës së saj[234], ndonëse ajo nuk e ushtron. Marrëdhënia e Ismetes me vegën zgjat prej më shumë se 40 vitesh. Është një marrëdhënie e nisur nga pasioni, por e mbajtur gjallë edhe nga bindja për të jetuar me punë të ndershme. Ajo nuk e ka ndërprerë asnjëherë punën – edhe pas mbylljes së Ndërmarrjes së Qilimave. Aktualisht, Ismetja është ndër të vetmet artizane që vazhdon të prodhojë qilima të përmasave të mëdha, me një cilësi të mirë. Ndonëse punon edhe sipas porosive, modelet e saj më të parapëlqyera janë ato që ka punuar dikur, e që ishin dizenjuar nga byroja e Leshpunueses. Ajo ruan ende një koleksion me skica të asaj periudhe, por thotë se në të vërtetë, modelet i ka të memorizuara dhe mund t'i aplikojë me lehtësi[235].

47. Artizanja Ismete Shaba, ndër qilimpunueset veterane të Kavajës, duke treguar një prej punimeve të saj. Prill 2023.

48. Qilima të punuar nga Ismete Shaba. Prill 2023.

Ferid Qarri

Ndërsa Ferid Qarri është një artizan i brezit të dytë që merret me prodhimin e enëve të ndryshme e veglave të thjeshta të punës prej metali. I kufizuar nga lënda e parë – kryesisht llamarinë e trashësisë së ndryshme, Feridi megjithatë përpiqet t'i pasurojë disa nga produktet e tij me elementë artistikë[243], të realizuar modestisht me pajisje të thjeshta, vlera muzeale e së cilave duhet çmuar. Ai është i vetmi artizan që e ka punishten në Rrugën e Artizanëve, në qendër të qytetit. Përvoja e gjatë me këtë zanat i mundëson atij që disa produkte t'i realizojë brenda pak minutash dhe t'i nxjerrë në shitje aty për aty, por me realizimin e më shumë produkteve të përmasave të vogla, Feridi do të jetë edhe më tërheqës për vizitorët.

66. Punime llamarine të realizuara nga artizani Ferid Qarri, Janar 2023.

Rruga e Artizanëve, Kavajë
41°11'01.9"N 19°33'44.9"E

+355 692591733

Sigurisht që përveç këtyre pasionantëve të trashëgimisë, Kavaja ka edhe poçarë të tjerë sikurse mjeshtre qilimash, qëndistare dhe metalpunues që këmbëngulin të mbijetojnë me artizanat në epokën dixhitale. Ata janë pjesëmarrës në mjaft panaire lokale[244] e më gjerë.

Secili më vete – dhe të gjithë bashkë – ata kanë potencialin ta kthejnë qytetin e tyre në hartën e artizanatit shqiptar, një vend që vetëm një shekull më parë, Kavaja e mbante me nder e krenari.

Shënime dhe referenca:

216 "Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kavajë", miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, dt. 27 Prill 2018
217 Bashkia Kavajë, "Plani i Detajuar Vendor i zonës 1, zona e re për zhvillim 1, Njësia Administrative Kavajë, Bashkia Kavajë", Kavajë 2021
218 "Bashkia Kavajë. Profil i Përgjithshëm", Kavajë 2018
219 Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, "Katalog i produkteve Made in Albania", Tiranë, 2020, 2022
220 Raymond E. Zickel, Walter R. Iwaskiw, "Albania, a country study", Washington 1992
221 Zyhdi Shehi, "Kavaja: trajtesa historike", Durrës, 2017
222 DRTK Tiranë, 2 Shtator 2020 (https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=187977132769264&id=102049624695349)
223 DRTK Tiranë, 8 Shtator 2020 (https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=189537769279867&id=102049624695349)
224 "Bashkia Kavajë hap tenderin, ish-fabrika e Qelqit kthehet në treg", në "Albanian Construcion Portal", 10 Janar 2022 (https://acp.al/news/13285/Bashkia-Kavaje-hap-tenderin,-ish-fabrika-e-Qelqit-kthehet-ne-treg/)
225 Вера Филимонова, "Экскурсия на частную керамическую фабрику в Кавае и мастер-класс у гончарного круга", 2015
226 Artizanet Lulzime Krasnaj dhe Suzana Istrefi janë të njohura për punimet masive me grep.
227 Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, "Artizanet e Kavajës", Kavajë 2023
228 Qendra e Zhvillimit të Artizanatit Kavajë, Gjimnazi "Aleksandër Moisiu", Kati 1, Shëtitorja "Indrit Cara", Kavajë
229 Banka Kombëtare Tregëtare, Mandat elektronik, Dt. 30.12.2022
230 Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, "Artizanet e Kavajës", Kavajë 2023
231 Myrvete Topi, Lulëzime Krasnaj, Florida Gjergji, intervistë, Kavajë 5 Maj 2023
232 Kostandin Kostrista, videointervistë, Kavajë, 6 Maj 2023
233 Ligor Kostrista, videointervista, Kavajë, 6 Maj 2023
234 Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, "Artizanet e Kavajës", Kavajë 2023
235 Ismete Shaba, intervistë, Kavajë, 5 Maj 2023
236 Myzejen Hoxha, videointervistë, Kavajë, 4 Maj 2023
237 Luçie Hoxha, videointervistë, Kavajë, 4 Maj 2023
238 Myrvete Topi, intervistë, Kavajë, Maj 2023
239 Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, "Artizanet e Kavajës", Kavajë 2023
240 Lulzime Krasnaj, pyetësor për artizanet, Kavajë, 9 Maj 2023
241 Suzana Istrefi, pyetësor për artizanet, Kavajë, 9 Maj 2023
242 Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, "Artizanet e Kavajës", Kavajë 2023
243 Ferid Qarri, bisedë, Kavajë, 1 Prill 2023
244 Ministria e Kulturës, "Raportet e monitorimit: 12-mujori viti 2019", Tiranë, 2020

67. Ndër elementët identifikues të mbetur nga Fabrikës së Qelq-Xhamit Kavajë: oxhakët. Maj 2023.

skice e te gjithe destinacioneve

Arkeologjia industriale dhe punishtet si destinacione të turizmit të përvojës

Me një vijë bregdetare prej rreth 30 km, përgjatë të cilave shtrihen disa nga plazhet më të frekuentuara në vend, territori i Bashkisë Kavajë mirëpret mijëra turistë nga e gjithë bota. Të ardhurat nga ky turizëm mbajnë peshën kryesore të ekonomisë lokale. Mirëpo përkundër mbipopullimit të plazheve nga Mali i Robit e deri në Boshtovë, vetë qyteti i Kavajës, ndonëse 5-6 km larg, mbetet pak i frekuentuar nga vizitorët e sezonit veror, ndërsa gjatë stinëve të tjera, numri i vizitorëve është edhe më i vogël.

Prandaj ky botim mëton të tërheqë vëmendjen e autoriteteve vendore e qendrore, të udhërrëfyesve dhe operatorëve turistikë, drejt nevojës për të ndryshuar këtë raport, në përpjekje për të evidentuar Kavajën edhe si një destinacion të turizmit kulturor. Kjo ftesë vjen përmes paraqitjes së disa prej aktorëve më të gjallë të trashëgimisë materiale dhe sidomos asaj shpirtërore, si destinacion për atë kategori të vizitorëve të interesuar për traditën. Për këtë arsye, në këtë kapitull do të prezantohet ish-Fabrika e Qelqit - e vetmja në Shqipëri që prodhonte xham; Muzeu Etnografik – një kapsulë

kohore ku ruhen objekte dhe histori të kujtesës kolektive me vlerë të pallogaritshme. Krahas tyre janë Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, një nisëm e grave duararta të Kavajës që duhet mbështetur dhe promovuar, si dhe sipërmarrja "End e Thur" e qilimave të artizanes veterane Ismete Shaba. Megjithatë, për nga dijebërja, punishtja "Korstrista" është e krahasueshme me një muze më vete, sepse përfaqëson një trashëgimi 143-vjeçare të pasionit për poçarinë.

Këto janë destinacionet që paraqet ky botim, në këtë fazë embrionale të përpjekjeve për rikthimin e artizanatit në Kavajë. Në secilin prej këtyrë destinacioneve, vizitorët do të përjetojnë përvoja, së pari njerëzore dhe emocionale, e më pas edhe profesionale dhe estetike. Në disa prej tyre, ata do të kenë mundësi të sfidojnë vetveten në aplikimin e dijeve dhe aftësive të tyre në zejet përkatëse, duke u larguar nga punishtet me ndonjë produkt që e kanë krijuar me duart e veta. Për disa vizitorë, kjo mund të jetë më emocionuese se sa marrja e rrezeve të Diellit në një shezllon plazhi.

68. Skica të modeleve të dizajnit të qilimave, pjesë e koleksionit personal të ruajtur nga artizanja Ismete Shaba, Janar 2023.

FABRIKA E QELQT - KAVAJE
5q
RP. SHQIPËRISË

Ish-Fabrika e Qelqit

Rruga “Taulantia”, ndërmjet rrugës së Vezëve, rrugës “Dituria” dhe Shëtirores “Kavaljon”

41°10’44.4”N 19°33’36.7”E

Ish-Fabrika e qelq-Xhamit përbën një potencial të arkitekturës industriale krejtësisht të pashfrytëzuar nga turizmi. Ajo mund të ishte atraksioni kryesor i Kavajës, pasi përfaqëson ëndrrën jetëshkurtër të një qyteti të vogël për të t'u bërë i njohur dhe për të kontribuar në zhvillimin kombëtar me një produkt unik, pavarësisht cilësisë së këtij produkti apo efiçencës ekonomike të vetë Fabrikës. Në këtë mënyrë, me Fabrikën e Qelq-Xhamit, Kavaja kishte momemtumin e vet në histori, një mundësi që rrallë u vjen dy herë qyteteve të vogla.
Me një sipërfaqe prej rreth 5500 m^2, Fabrika ndodhet në anën lindore te rrugës “Taulantia”, në parcelën ndërmjet rrugës së Vezëve, rrugës “Dituria” dhe Shëtirores “Kavaljon”. Aktualisht ajo përfaqësohet nga disa kapanone, pesë oxhakë, disa ndërtesa të shkatëruara, si dhe një seri pusesh të shpërndara përgjatë territorit. Në gjendje më të mirë paraqiten tre kapanone të bashkëngjitur me përmasa rreth 60x12m secili në skajin perëndimor të Fabrikës. Ngjitur me to, në anën lindore

69. Pamje e pjesshme e ish-Fabrikës së Qelq-Xhamit Kavajë: një oxhak tjetër dhe mbetje xhami. Maj 2023.

është gërmadha e një ndërtese të madhe 3-katëshe. Më në jug, po të bashkëngjitur, janë dy kapanone të tjera më të vogla, me përmasa 18x10m secili. Ngjitur me to janë 8 dhoma me përmasa afërsisht 9x9 m, me mure betoni të dëmtuara rëndë. Rreth 30 m në jug të tyre shfaqet platforma betoni e një strukture që ka mbajtur një rezervuar kimikatesh. Më në lindje shihen edhe rrënojat e një ndërtese tjetër me përmasa 16x8 m, me 6 ndarje. Pjesa më tërheqëse e këtij destinacioni janë oxhakët konikë me lartësi rreth 30, 40 dhe 55 m, katër të ndërtuar me tulla dhe një tjetër me beton. Dy oxhakë janë në pjesën veriore, dy të tjerë në pjesën lindore dhe një në jug. Diametri i jashtëm i një oxhaku me tulla në kuotën 0 është 5.2 m, ndërsa në kuotën 40 m është 1.6 m[245]. Në majën e njërit prej tyre, gjatë dekadave të fundit është vendosur një instalacion llamarine i ngjashëm me objektet e kultit. Gjurmët e rrugëve, lulishteve, ndërtesave

të tjera, si dhe puseve të shumta që kanë pasur funksione të caktuara në kohën kur Fabrika ishte në kapacitet të plotë, janë zhdukur për shkak se territori vazhdon të përdoret si venddepozitim i paligjshëm inertesh dhe mbetjesh të tjera.
E ndërtuar përgjatë viteve 1968-1970, Fabrika e Qelq-Xhamit kishte rreth 728 makineri dhe pajisje, mbi 700 tona konstruksione metalike dhe mbi 10 km tubacione[246] të lëndëve të ndryshme që shtriheshin brenda ndërtesave dhe nga njëra ndërtesë në tjetrën. Fabrika vazhdoi të funksiononte deri në fillim të viteve '90 të shekullit XX, kur puna u ndërpre si pasojë e mungesës së lëndës së parë. Që prej asaj kohe, Fabrikës i janë shembur pa lënë asnjë gjurmë ndërtesa të mëdha me funksione të ndryshme, si adminsitrative, reparte pune, magazinimi etj. Në disa segmente periferike të parcelës ku shtrihej Fabrika, janë ndërtuar banesa dhe objekte të tjera private, ndërsa procesi i privatizimit të plotë të ndërmarrjes mbetet ende i paqartë.[247]



70. Ortofoto e vitit 1994 nga Fabrika e Qelq-Xhamit, Kavajë.

71. Ortofoto e vitit 2007 nga Fabrika e Qelq-Xhamit, Kavajë.

72. Ortofoto e vitit 2015 nga Fabrika e Qelq-Xhamit, Kavajë.

73. Ortofoto e vitit 2020 nga Fabrika e Qelq-Xhamit, Kavajë.

MUZEU
ETNOGRAFIK
KAVAJË

Muzeu Etnografik

Muzeu Entografik është i vendosur në një shtëpi karakteristike mesjetare, dikur në pronësi të një prej familjeve të njohura kavajase – Arkaxhiu – në rrugën "Mehmet Babamusta", në koordinatat 41°10'49.6"N 19°33'20.3"E. Ndërtesa dykatëshe me çardak – tipike e zonës – i takon shekullit XIX[248] dhe është ndërtuar duke përdorur materiale tradicionale, si tullat e qerpiçit, një përzierje e argjilës me kashtën. Pas restaurimit të plotë, ndërtesa me sipërfaqe ekspozimi të brendshëm rreth 850m^2 u kthye në muze, me statusin "Muzeu Etnografik i Rrethit të Durrësit"[249] dhe u përurua më 8 Nëntor 1971. Dy vjet më vonë, vetë ndërtesa u shpall Monument Kulture i Kategorisë I[250], dhe që atëherë ajo ka pritur mijëra vizitorë nga vendi dhe bota, me një mesatare vjetore prej afro 550 vizitorësh.

Ky muze përfaqëson një ndër muzetë më të kompletuar etnografikë të Ultësirës Perëndimore e më gjerë, me një inventar të pasur artefaktesh, ku dominojnë punimet tradicionale të qeramikës, veshjet popullore dhe mjetet

Rruga "Mehmet Babamusta", 2501, Kavajë
41°10'49"N 19°33'20"E

+355 698401625

e veglat prej guri, druri e metali, krahas punimeve të mjeshtrit të shquar të shekullit XVIII, Kostandin Shpataraku[251]. Në muze gjenden edhe ekzemplarë të produkteve të artizanëve kavajas, të realizuara në ndërmarrjet shtetërore gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, si në qeramikë, qelq, tekstil, metal, alabastër etj. Që nga antikiteti, mesjeta, rilindja, pavarësia dhe epoka e socializmit, Muzeu përmban rreth 807 objekte, pa llogaritur disa objekte të tjera që janë në proces inventarizimi[252].

I dëmtuar rëndë nga tërmeti i vitit 2019, Muzeu i është nënshtruar një rikonstruksioni të plotë, së bashku me eksponatet e thyera, të cilat gjithashtu po restaurohen. Në përfundim të këtij procesi, Muzeu Etnografik do te jëtë në gjendje të mirepresë shumë herë më shumë vizitorë – si destinacioni kryesor për të gjithë ata që kanë interes të njohin Kavajën dhe zonën përreth, e sidomos për adhuruesit e artizanatit.

74. Pamje nga jashtë e Muzeut Etnografik të Kavajës, përpara restaurimit.

KAVAJĖ

Qendra e Zhvillimit të Artizanatit

Nxitja dhe zhvillimi i mjeshtrive të artizanatit lokal, transferimi i njohurive te brezi i ri, përmirësimi i aftësive teknike të artizanëve, si dhe promovimi i produkteve të tyre në treg – janë objektivat kryesore të Qendrës së Zhvillimit të Artizanatit[253]. Që prej muajit Shkurt 2023 kur u themelua, Qendra po tenton të kthehet jo vetëm në një strehë të përbashkët ku artizanet kavajase shkëmbejnë modele e teknika, por në një shkollë të vërtetë për brezin e ri të artizanëve të cilit po i transmetohet zejtaria. Fillimisht ky brez përfaqësohet nga fëmijët dhe familjarët e artizaneve, por me kohë pjesë e tij do të jenë edhe kursantë të rinj, të cilët do të duan të mësojnë si të krijojnë produkte moderne me teknika tradicionale.
Brenda pak muajve, mjaft artizane janë anëtarësuar në këtë Qendër dhe pritshmëritë janë që ky numër të rritet në vazhdimësi.

Gjimnazi “Aleksandër Moisiu”,
K. 1 , Shëtitore “Indrit Cara”
41°10’57.0”N 19°33’43.1”E

+355 688298511

grupiartizanetekavajes@gmail.com

Qendra e Zhvillimit të Artizanatit ndodhet në Shëtitoren "Indrit Cara", me koordinata 41°10′57.0″N 19°33′43.1″E, në katin e parë të Gjimnazit "Aleksandër Moisiu" të Kavajës. Ajo përfaqësohet nga një hapësirë modeste prej rreth 40 m^2, me orientim nga lindja. Falë dritareve të gjera, mjedisi është i ndriçuar mirë. Aty janë vendosur 3 makineri të mëdha: një tezgjah (vegjë) e madhe vertikale, në të cilën punohen qilimat, si dhe dy makina qepëse/qendisjeje elektrike. Në disa prej rafteve janë të ekspozuara punime të ndryshme të artizaneve. Kontrata e nënshkruar në vitin 2022 me Bashkinë Kavajë[254], i siguron njëfarë autonomie Qendrës së Artizanatit, në harmoni me orarin dhe rregullat e brendshme të gjimnazit, e megjithëse Qendra është e hapur çdo ditë të javës, dita më e favorshme për ta vizituar atë është e Shtuna.

75. Duart e një artizaneje gjatë punës në Qendrën e Zhvillimit të Artizanatit, Kavajë.

76. Pulexhat që tendosin litarët e pedaleve të tezgjahut.

KOSTRISTA
CERAMIC ART – 1880

Kostrista Ceramic Art

Punishtja "Kostrista" ndodhet rreth 50 m në brendësi të rrugës "Pal Xhumari", përballë Stadiumit "Besa" të qytetit të Kavajës, në koordinatat 41°11'19.4"N 19°33'03.4"E. Në të vërtetë kjo është shtëpia e familjes Kostrista, kati i parë dhe oborri i pasëm i së cilës shërben si punishte e poçarit Ligor Kostrista. Në total janë rreth 380 m^2 mjedise, të organizuara sipas nevojave të punës.

Në mjediset e brendshme, majtas është një hapësirë pushimi dhe ekspozimi, ndërsa djathtas dhe në korridorin kryesor janë vendosur rafte për ekspozimin dhe njëherësh magazinimin e produkteve të përfunduara. Më në thellësi, majtas është reparti i tornove me dy të tilla, dhe përballë tij, sërish një magazinë e vogël produktesh. Pasi kalon përmes katit të parë, dilet në një oborr të madh, i cili është pjesa tjetër e punishtes. Ligori i kryen vetë të gjitha proceset, që nga nxjerrja e lëndës së parë në kodrat e Mengës, të Habiljave etj. Prandaj në të djathtë të oborrit lënda e parë gjendet në sasi të mëdha dhe në disa forma: në formë gurësh, në formë balte të thatë, si dhe në formë

Rruga "Pal Xhumari", përballë Stadiumit "Besa"
41°11'19.4"N 19°33'03.4"E

+355 682162452

kostrista_ceramicart

Kostrista Ceramicart

77

78

79

80

të lëngshme. Pranë secilit venddepozitim të lëndës së parë janë makineritë përkatëse që shërbejnë për të thërrmuar gurët, për të ngjeshur baltën, për ta përzierë etj. Në oborr gjenden tre furra për pjekjen e produkteve të poçarisë: e para djathtas është në furrë e vjetër me dru, në fund të oborrit, po djathtas është një furrë moderne me gaz, me temperaturë të kontrollueshme dhe me kapacitet rreth 4m^3, ndërsa përballë saj, në të majtë gjendet një furrë tjetër më e vogël, e përdorshme me dru, gaz apo mazut. Pranë kësaj të fundit ngrihet një repart tjetër pune, për realizimin e produkteve me forma (shabllon), ndërsa qendra e oborrit është rezervuar për hapjen e punimeve të qeramikës për t'u tharë, përpara futjes për pjekje.

Në këto mjedise pune, Ligor Kostrista, me ndihmën edhe të të dy djemve, realizon një numër të madh produktesh, kryesisht të poçerisë së trashë, në varësi të kërkesave të konsumatorëve[255]. Megjithatë nuk mungojnë produktet e përmasave më të vogla, me forma, dizajn e glazurë.

77. Një prej tornove në repartin e brendshëm të punishtes "Kostrista Ceramic Art".

78. Furra e vjetër e punishtes "Kostrista Ceramic Art".

79. Enë balte të prodhura në punishten "Kostrista Ceramic Art".

80. Artizani Ligor Kostrista dhe djali i tij i dytë, Franko, gjatë punës në "Kostrista Ceramic Art".

81. Pamje e pjesshme e mjediseve të tharjes së produkteve në punishten “Kostrista Ceramic Art”.

End e Thur

QILIMA ARTIZANALË

End e thur

End e thur është sipërmarrja e artizanes Ismete Shaba. Ajo gjendet në rrugën "Taulantia", rreth 60 m përballë skajit më perëndimor të ish-Fabrikës së Qelqit, në koordinatat 41°10′46.2″N 19°33′24.9″E. E përbërë nga vetëm një mjedis me sipërfaqe rreth 12 m^2, punishtja e Ismetes është një dhomë e shtuar në pjesën e pasme të shtëpisë së saj përdhese të banimit, një ndërtesë private tipike e Kavajës së çerekut të fundit të shekullit XX. Përgjatë oborrit vizitorët shoqërohen nga aromat dhe ngjyrat e luleve, perimeve dhe pemëve të shumta frutore, ndërsa bashkë me ritmin e vegjës, ata mund të dëgjojnë edhe zërat e kecave dhe deleve – dy angazhime të tjera që ia mbushin ditën artizanes.

Tezgjahu i madh prej druri, me boshtet dhe levat prej hekuri, është e vetmja makineri e kësaj punishteje modeste. Ai nuk është asnjëherë bosh, sepse sapo mbaron një qilim a rrugicë, Ismetja fillon një tjetër. Pjesa tjetër e dhomës shërben edhe si vend magazinimi i pajisjeve të tjera të rëndësishme për familjen e vogël, përfshi edhe një kazan të madh për zierjen e rakisë, si dhe sobën e druve.

Rruga "Taulantia", përballë ish-Fabrikës së Qelqit, Kavajë
41°10′46.2″N 19°33′24.9″E

+39 38 99392349
+355 55246886

end_ethur

End e Thur

82. Artizanja Ismete Shaba në tezgjahun e punishtes së saj “End e thur”.

Shënime dhe referenca:

245 Tomson Frashëri, "Oxhaqet industriale me murature tulle të zakonshme", në Revistën "Ndërtuesi", Nr. 3 (8), Tiranë, Qershor 1969
246 Irfan Veterniku, "Të njihemi me veprat tona: Fabrika e Qelqit", në Revista "Ndërtuesi", Nr. 3 (8), Tiranë, Qershor 1969
247 Sheref Zenelaj, "Kujtesë. Kavaja në vitet 1930-1940 simbas kujtimeve të bashkëkohësve", Kavajë 2000
248 Muzeu Etnografik Kavajë "Muzeu Etnografik Kavajë", Tiranë 1982
249 Muzeu Etnografik Kavajë "Muzeu Etnografik Kavajë", Tiranë 1982
250 Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, Vendim Nr. 1886, 10 Qershor 1973
251 Muzeu Etnografik Kavajë "Muzeu Etnografik Kavajë", Tiranë, 1982
252 Stefanaq Sotja, bisedë, Kavajë, Maj 2023
253 ANRD, "Qendra e Zhvillimit të Artizanatit Kavajë", Kavajë 2023
254 Suzana Istrefi, bisedë, Kavajë, 6 Maj 2023
255 Ligor Kostrista, videointervista, Kavajë, 6 Maj 2023

Burime

"Bashkia Kavajë hap tenderin, ish-fabrika e Qelqit kthehet në treg." *Albanian Construction Portal*, 10 Janar 2022, https://acp.al/news/13285/Bashkia-Kavaje-hap-tenderin,-ish-fabrika-e-Qelqit-kthehet-ne-treg/

"E para Ekspozitë Artizanati në Tiranë e zhvillimi i pûnës në Shqypní". *Hylli i Dritës*, Nr. 7-8, Shkodër, 1931.

"Glass engraving." *New Albania,* nr. 4, Tirana, 1977.

"Kronikë kulturore." *Drita*, Tiranë, 19 Nëntor 1972.

"Letter of the CC of the Party of Labour and the Government of Albania to the CC of the Communist Party and the Government of China." *Albania Today,* Nr. 4, Tirana, 1978.

"Ligj Nr. 5506". *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Tiranë, 28 Dhjetor 1976.

"Mbi Planin e Dytë Pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë popullore të Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë viteve 1956-1960." *PPSH Dokumenta kryesore 1949-1956*, 2 Qershor 1956, Vëllimi II, Kongresit III të Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 1972.

"Nëpër institutet tona studimore dhe projektuese." *Ndërtuesi*, Nr. 1 (86), Tiranë, Janar - Shkurt - Mars 1986.

"Sistemi i rí shkolluer." *Hylli i Dritës*, Nr. 10, Shkodër, 1922.

"The Albanian carpets." *New Albania*, Nr. 1, Tirana, 1972.

"Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH Mbi masat për ngritjen e mëtejshme të nivelit të jetesës së punonjësve." *PPSH Dokumenta kryesore, 1949 - 1956*, Vëllimi II, 25 Dhjetor 1953, Instituti i Studimive Marksiste-Leniniste, Tiranë, 1972.

"Woven works of art". *New Albania*, Nr. 3, Tirana, 1977.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. *Katalog i produkteve Made in Albania*. Tiranë, 2020, 2022.

Albania. Istituto Nazionale Luce, 1937.

Albanian popular motives textiles and needlework. State University of Tirana, Tirana, 1959.

Album për gjeografinë ekonomike të Shqipërisë. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1984.

Alia, Ramiz. *Fjalime e biseda Qershor-Dhjetor 1987*. Tiranë, 1988.

Annuario del Regno di Albania. Milano, 1940.

Ansambli Liaonin. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1972.

Arti në Republikën popullore të Shqipërisë. Berlin, 1953.

Artizanet e Kavajës. Qendra e Zhvillimit të Artizanatit, Kavajë 2023.

Baboçi, Sheri. "Albania in International Fairs and Exhibitions". *New Albania*, Nr. 6, Tirana, 1970.

Bashkia Kavajë. Profil i Përgjithshëm. HELVETAS Swiss Intercooperation, Tiranë, 2018.

Beqiri, Mustafa. "Mbi 50 grupe amatore". *Drita*, Tiranë, 20 Dhjetor 1970.

Bérard, Victor. *La Turquie et l'hellénisme contemporain*. Hachette Bnf, Paris, 1897.

Bonasera, Francesco. "Katrovat e Fushës së Kavajës". Leka, nr. 6, Qershor 1943.

Bourcart, Jacques. *L'Albanie et les Albanais*. Bossard, Paris, 1921

Bourcart, Jacques. *Les confins albanais administrés par la France (1916-1920): contribution à la géographie et à la géologie de l'Albanie Moyenne*. Librairie Delagrave, Paris, 1922.

Buletini Informativ. Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë, Nr. 2, Tiranë, 1970.

Burileanu, Constantin N. *Romeni di Albania*. Bologna, 1912.

Calmes, Albert. *The economic and financial situation of Albania*. Impr. A. Kundig, Geneva, 1922.

Çarçani, Adil. "Socialist Albania - country of new reality and of the new man." *Albania Today*, Nr. 1, Tirana, Januar-February 1974.

Kinokronika Nr. 9. Me regji nga A. Çela, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1974.

Çela, Mitro. "Rrënjët e Kavajës". *Fjala*, Tiranë, 24 Qershor 2020.

Çelebi, Evliya. *Shqipëria 350 vjet më pare*. Tiranë, 2003.

Craveri, Michele. *Albania. Il paese e le genti*. Antonio Vallardi Editore, Milano, 1939.

Culture people's heritage. Tirana, 1973.

Dal Piaz, Giorgio. De Toni, Antoni. Almagià, Roberto. *Relazione della Commissione per lo studio dell'Albania*. Tipografia Nazionale di G. Bertero E C., Roma, 1915.

Delegacioni i punëtorëve Kinezë në vendin tonë. Me regji nga G. Dhrimaj, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1972.

Demaria, Giovanni. *Principi di economia Albanese*. Cedam, Padova, 1941.

Dingu, Kadri. *Lufta e PPSH për transformimin socialist të zejtarëve për zhvillimin e Kooperativave të Artizanatit dhe shndërrimin e prones së tyre në pronë të të gjithë popullit*. Tiranë, 1979.

DRTK Tiranë. Facebook, 2 Shtator 2020, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=187977132769264&id=102049624695349

DRTK Tiranë. Facebook, 8 Shtator 2020, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=189537769279867&id=102049624695349

Durham, Edith. "Albania: Oldest and Quaintest of Balkan People." *Peoples of All Nations*, No. 1, London, 1922.

Dushku, Fuat. "Artizanati ynë në panairet ndërkombëtare." *Drita*, Tiranë, 21 Qershor 1970.

Dushku, Fuat. "Mbi disa probleme të qeramikës së artizanatit dhe të qeramikës artistike." *Nëntori*, Nr. 5, Tiranë, 1964.

Fëmijët, qelqi dhe balta. Me regji nga Saimir Kumbaro, Nazmi Roli dhe Nexhati Tafa, Tiranë, 1974.

Ferid, Qarri. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, 1 Prill 2023.

Fishta, Gjergj. "Nji udhtim në Turkí të Ré." *Hylli i Dritës*, Nr. 2, Shkodër, 1932.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Redaktuar nga A. Buda, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1985.

Frashëri, Tomson. "Oxhaqet industriale me murature tulle të zakonshme". *Ndërtuesi*, Nr. 3 (8), Tiranë, Qershor 1969.

Gjergji, Andromaqi. "Arti popullor shqiptar." *Nëntori*, Nr. 8, Tiranë ,1954.

Gjergji, Andromaqi. *Bibliografi e etnografisë shqiptare 1944-1979*. Tiranë, 2021.

Gogollari, Dhimo. "Prodhime të tezgjahut tone." *Drita*, Tiranë, 27 Qershor 1971.

Haberlandt, Arthur. *Kulturwissenschaftliche Beiträge zur Volkskunde von Montenegro, Albanien und Serbien*. Wien, 1917.

Haxhihyseni, Ismail. *Këshilla mbi të vumen e mëndafshit*. Elbasan, 1921.

Historia e Bankës Qendrore në Shqipëri. Meta Beqir (recenzent). Redaktuar nga Adriana Meko, Tiranë, 2003.

Hoxha, Enver. *Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë*. Tiranë, 20 Dhjetor 1974.

Hoxha, Luçie dhe Hoxha, Myzejen. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, 4 Maj 2023.

Hoxha, Rifat. *Njerëz, karaktere, mbresa*. Durrës, 2022.

Hudhri, Ferid. "Interesimi duhet të jetë më i madh edhe për gjinitë më të vogla." *Drita*, Tiranë, 30 Mars 1980.

Inventari i Dokumentacionit i Vitit 1959. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

Istrefi, Suzana. *Pyetësor për artizanët e Kavajës*. GO2Innovation, Kavajë, 9 Maj 2023.

Jacomoni Di San Savino, Francesco. *La politica dell'Italia in Albania - Nelle testimonianze del Luogotenente del Re*. Cappelli, Bologna, 1965.

Kadlec, Josef Maria. *Dnešní Albanie*. Praze, 1926.

Katalog 1979. Ndërmarrja e Prodhimeve Qeramike Kavajë, Kavajë, 1979.

Kaucky, Miroslaw. "Mittelalbanische Stadt- und Wirtschaftsbilder". *Österreichische Monatsschrift für den Orient*, Nr. 1-6, Wien, Januar-Juni 1916.

Kavaja Lajme. Facebook, 25 Tetor 2020, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=141186357725110&id=100935175083562

Kavaja në 40-vjetorin e Çlirimit. Muzeu Historik Kavajë, Durrës, 1984.

Këshilli i Ministrave. "Korrespondencë e Ministrisë së Industrisë dhe Minierave, Komisionit të Planit me Aparatin e Këshillit të Ministrave mbi prodhimin, planin e shpërndarjes të prodhimeve prej qelqi si dhe plani i masave për përmirësimin e punës në industrinë e qelqit dhe qeramikës." *Dosja nr. 751*, Tiranë, 1959.

Këshilli i Ministrave. "Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, datë 30.08.1958, raport, pasqyra dhe informacione, mbi prodhimin dhe furnizimin e tregtisë e kooperativave, me artikuj, mobilje, orendi, tulla, tjegulla e poçeri.", *Dosja nr. 644*, Tiranë, 1958.

Këshilli i Ministrave. "Procesverbali dhe vendimi i Kryesisë së Këshillit të Ministrave datë 27.10.1987, mbi krijimin e Ndërmarrjes së Materialeve Dekorative të Ndërtimit në qytetin e Kavajës, relacioni i Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ministrisë së Ndërtimit për këtë problem. 10.27.1987 - 11.05.1987." *Dosja nr. 263*, Tiranë, 1987.

Këshilli i Ministrave. "Relacion dhe informacion i Ministrisë së Industrisë dhe Minierave dhe Komisionit të Kontrollit të Shtetit dhe procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, datë 30.08.1958, mbi prodhimin dhe furnizimin e tregtisë dhe kooperativave me artikuj mobilje, orendi, tulla, tjegulla e poçeri." *Dosja nr. 43*, Tiranë, 1958.

Këshilli i Ministrave. "Relacion dhe vendim i Këshillit të Ministrave mbi një shtesë në planin e investimeve të Kooperativës të Poçerisë në Tiranë për 3/mujorin e katërt të vitit 1952." *Dosja nr. 791*, Tiranë, 1952.

Këshilli i Ministrave. "Relacion i Ministrisë së Industrisë e Minierave dhe vendimi përkatës për krijimin e Ndërmarrjes Industriale Shtetërore e Qeramikë-Qelqit në Tiranë." *Dosja nr. 601*, Tiranë, 1957.

Këshilli i Ministrave. "Relacione të NISH Qeramikës dërguar Aparatit të Këshillit të Ministrave mbi zbatimin e eksperiencës Kineze." *Dosja nr. 672*, Tiranë, 1961.

Këshilli i Ministrave. "Relacione, informacione, skica e korrespondencë të Ministrisë së Ndërtimit e Industrisë drejtuar aparatit të Këshillit të Ministrave, mbi ndërtimin e fabrikës së qelqit e të xhamit Kavajë." *Dosja nr. 804*, Tiranë, 1965.

Këshilli i Ministrave. "Relacioni i Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit, shqyrtuar në Kryesinë e Këshillit të Ministrave datë 29.03.1956, mbi dhënien e disa kapanoneve Bashkimit Qendror të Kooperativave të Artizanatit Kavajë për transferimin e Fabrikës së Litarit nga Rrogozhina." *Dosja nr. 197,* Tiranë, 1956.

Këshilli i Ministrave. "Relacioni me projektvendim të Komisionit të Planit të Shtetit, mbi shtimin e prodhimeve të poçerisë." *Dosja nr. 317,* Tiranë, 1955.

Këshilli i Ministrave. "Vendim i Këshillit të Ministrave dhe materiali përkatës, mbi mekanizimin e zdrukthtarisë dhe poçerive." *Dosja nr. 680*, Tiranë, 1958.

Këshilli i Ministrave. "Vendim i Këshillit të Ministrave dhe relacioni me projektvendimin përkatës, mbi ndarjen e Ndërmarrjes Industriale të Qelq-Qeramikës Tiranë". *Dosja nr. 345*, Tiranë, 1960.

Këshilli i Ministrave. "Vendim i Këshillit të Ministrave, mbi heqjen e poçerisë së trashë, udhëzim mbi realizimin ritmik të planit të prodhimit të furnizimit të këtyre prodhimeve, si dhe relacion i Këshillit teknik të NISH qeramikës Tiranë, mbi variantet e ndërtimit të furrave në uzinën e porçelanit për pjekjen e prodhimeve dhe fonderisë artistike në Uzinën Enver". *Dosja nr. 735*, Tiranë, 1962.

Këshilli i Ministrave. "Vendim i Këshillit të Ministrave, së bashku me relacionin e Ministrisë së Tregtisë dhe Aparatit të Këshillit të Ministrave, mbi zbritjen e çmimeve me pakicë të shisheve dhe kavanozave prej qelqi". *Dosja nr. 222*, Tiranë, 1968.

Këshilli i Ministrave. "Vendime të Këshillit të Ministrave Nr.438 e 439 mbi çmimet me pakicë të poçerisë dhe të grumbullimit të lirë të patates". *Dosja nr. 460*, Tiranë, 1956.

Këshilli i Ministrave. "Vendimi i Komisionit Shtetëror i Rezervave të Naftës e të Gazit dhe Mineraleve të tjera të dobishme "Për miratimin e raportit gjeologjik të vendburimit të alabastrit gipsor në Mengaj (Kavajë) me llogaritje të rezervave me gjendje 31.07.1993", si dhe relacioni përkatës". *Dosja nr. 546*, Tiranë, 01.21.1984 - 02.20.1984.

Këshilli i Ministrave. "Relacion i Ministrisë së Arsimit e Kulturës mbi mbylljen e degës së qeramikës në Liceun Artistik me vendimin përkatës". *Dosja nr. 297*, Tiranë, 1963.

Kinoditari Nr. 2. Me regji nga Ylli Pepo, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1969.

Kinoditari Nr. 12. Me regji nga M. Zeqo, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1968.

Kinoditari Nr. 14. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1978.

Kinoditari Nr. 21. Me regji nga Ilia Dede, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1981.

Kinoditari Nr. 47. Me regji nga Halil Kamberi, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1970.

Kinokronika Nr. 13. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1975.

Kinokronika Nr. 26. Me regji nga Luan Rama, Kinostudio "Shqipëra e Re", Tiranë, 1974.

Kinokronika Nr. 3. Me regji nga Kristo Jorgji dhe Vangjush Furrxhi, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1973.

Koci, Sofokli. "Motive të artit popullor shqiptar". *Nëntori*, Nr. 3, Tiranë, 1975.

Kono, Piro. Halimi, Krenar dhe Karapici, Faik. "Industria e material ndërtimit - prapavijë e shëndoshë e ndërtimeve të pesëvjeçarëve". *Ndërtuesi*, Nr. 6 (41), Tiranë, Dhjetor 1974.

Kostrista, Kostandin. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, 6 Maj 2023.

Kostrista, Ligor. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, 6 Maj 2023

Krasnaj, Lulëzime, Gjergji, Florida dhe Istrefi, Suzana. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, 5 Maj 2023.

Krasnaj, Lulzime. *Pyetësor për artizanët e Kavajës*. GO2Innovation, Kavajë, 9 Maj 2023.

Krymi i mndashit. Shkodër, 1924.

Kuqali, Andon. "Mbi artizantin artistik (vërejtje dhe propozime)." *Nëntori,* Nr. 5, Tiranë, 1964.

Kur nis një këngë rinie. Me regji nga Kujtim Gjonaj dhe Luan Rama, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1975.

Kuteli, M. "Mbresa nga ekspozita Shqipëria socialiste në 20-vjetorin e saj". *Nëntori*, Nr. 4, Tiranë, 1965.

La giornata albanese alla Fiera del Levante di Bari. Istituto Nazionale Luce, 1939.

Lear, Edward. *Journal of a landscape painter in Albania*. London R. Bentley, 1851.

Llana, Sonja. "Histori/ Kavajë, 1959. Sixhade me profilin e V.I. Leninit". *Bulevard*, Durrës, 31 Tetor 2020.

Lleshi, Bashkim. "Shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë jo metalorë të Shqipërisë." *Rruga e Arbërit*, nr. 5 (189), Maj 2022.

Manifestimi shkelqyer i artit revolucionar Kinez. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1972.

Mazzei, Gualtiero. "Albania industrial." *Rivista "Albania"*, Nr. 5, Roma, Maggio XIX, 1941.

Me ansamblin Rugova të Pejës. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë ,1972.

Mihačević, Lovro. *Po Albaniji*. Matica hrvatska, Zagreb, 1911.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. *Vendim Nr. 1886*. 10 Qershor 1973.

Motive Dibrane. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë ,1972.

Muzeu Etnografik Kavajë. Muzeu Etnografik Kavajë, Tiranë, 1982.

Myftiu, Hiqmet. "Nëpër sallat e një muzeu të ri (Muzeu Historik i Kavajës)." *Bashkimi*, Tiranë, 25 Mars 1976, http://www.zemrashqiptare.net/news/14460/luan-cipi-dashuri-e-nderprere.html?skeyword=a

Në Institutin e Lartë të Arteve. Me regji nga Elpiniqi Coja, Kinostudio "Shqiperia e Re", Tiranë, 1977.

Në udhët e reja të jetës. Me regji nga Ilia Dede dhe Kristaq Dhamo, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1985.

Nowack, Ernest. "A Contribution to the Geography of Albania." *Geographical Review*, Nr. 4, London, October 1921.

Ohri, Savet. "Vendburimi i gips-alabastrit Gipsar-Mengaj". *Buletini i Shkencave Gjeologjike*, Nr. 3, Tiranë, 1985.

Olldashi, Kozeta. "Students in Overalls". *New Albania,* Nr. 1, Tirana, 1971.

Onuzi, Afërdita. "Disa të dhëna mbi punimin e baltës në fshatin Bradvicë (Korçë) dhe në qytetin e Kavajës." *Etnografia shqiptare, Nr. IX, Tiranë*, 1978.

Onuzi, Afërdita. "Mjeshtëria shtëpiake e punimit të enëve prej balte." *Etnografia shqiptare*, nr. X, Tiranë, 1979.

Pasqua, Roberta Belli. Caliò, Luigi Maria. Menghini, Anna Bruna. *La presenza italiana in Albania tra il 1924 e il 1943.* Roma, 2017.

Patsch, Karl. *Das Sandschak Berat in Albanien*. Wien Hölder, Wien, 1904.

Plani i Detajuar Vendor i zonës 1, zona e re për zhvillim 1, Njësia Administrative Kavajë. Bashkia Kavajë, Kavajë, 2021.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kavajë. Këshilli Kombëtar i Territorit, Nr. 2, 27 Prill 2018.

Pollo, Stefanaq. *Probleme të luftës për emancipimin e plotë të gruas*. Tiranë, 1969.
Qendra e Zhvillimit të Artizanatit Kavajë. ANRD, Kavajë, 2023.
Qilimat tanë. Me regji të Adriana Elini, Anxhelina Xharra dhe Fiqiri Haxhiu, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë. 1975.
Raportet e monitorimit: 12-mujori viti 2019. Ministria e Kulturës, Tiranë, 2020.
Rotheit, Rudolf. *Aus Albaniens Werdetagen*. Berlin, 1914.
Saraçi, Hamide. "Industrializimi i Kavajës, aty ku prodhoheshin telat me gjemba." *Standard*, Nr. 2037, Tiranë, 27 Shtator 2011.
Schnorr von Carolsfeld, Franz. *Archiv Fur Litteraturgeschichte*. Vol. XII, Leipzig, 1884.
Shaba, Ismete. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, 5 Maj 2023.
Shehi, Zyhdi. *Kavaja: trajtesa historike*. Durrës, 2017.
Shehu, Mehmet. *Raport mbi direktivat e Kongresit të 6 të PPSH mbi Planin V 5-vjeçar*. Tiranë, 1971.
Shqipëria - njohuri të përgjithëshme. Tiranë, 1981.
Shqipëria sot. Me regji nga Bashkim Hoxha dhe Vitore Çeli. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1975.
Sokoli, R. "Characteristic carpets and coverings". *New Albania*, Nr. 1, Tirana, 1976.
Sokoli, Ramadan. "Coppersmith with Golden Hands". *New Albania*, Nr. 6, Tirana, 1970.
Stefanaq, Sotja. *Bisedë*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, Maj 2023.
Sulo, Pleurat. "Krijime të bukura në qeramikë". *Drita*, Tiranë, 11 Korrik 1971.
Susan Warren, "China on Africa's Fight for Independence". *New China*, Nr. 4, New York, 1978.
Tajani, Filippo. L'avvenire dell'Albania. U. Hoepli, Milano, 1932.
Takime të gëzuara. Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1971.
Tartari, Fatos. "Enë qelqi të shekujve I-IV të e. sonë nga Shqipëria." *Iliria*, Nr. 1-2, Tiranë, 1996.
Të reja nga Shqipëria Nr. 1. Kinostudio "Shqipëria e Re", 1969.
The Albanian Woman - a great force of the revolution. "8 Nëntori" Publishing House, Tirana, 1978.
Thomai, Gjergj. Struga, Fatlinda. Boriçi, Oketa. Tallushi, Nerxhana. *Kavaja Zhvillimi urban 1945-1990*. Botimet Flesh, Tiranë, 2020,
ti. "Burrimet e rrnesës shqyptare". *Hylli i Dritës*, Nr. 3, Shkodër, 1933.
Topi, Myrvete. *Rrëfime nga artizanët e Kavajës*. Intervistuar nga GO2Innovation, Kavajë, Maj 2023.
Tourist Guide book of Albania 1969. "Naim Frashëri" Publishing House, Tirana, 1969.
Udhëtim në pranverë. Me regji nga Qerim Mata, Gjergj Vlashi, Kinostudios "Shqipëria e Re", Tiranë, 1975.
Vajzat e Fabrikës së Qelqit (Kavajë). Kënduar nga Thabit Rexha, https://www.youtube.com/watch?v=mLpYXhpPGXk
Veterniku, Irfan. "Të njihemi me veprat tona: Fabrika e Qelqit." *Ndërtuesi*, Nr. 3 (8), Tiranë, Qershor 1969.
Vjetari Statistikor i Shqipërisë, 1991. Drejtoria e Statistikës në Ministrinë e Ekonomisë, Tiranë, 1991.
Wallisch, Friedrich. *Neuland Albanien*. Franckh'sche Verlagshangdlung, Stuttgart, 1931.
Women in development. U.S. Agency for International Development, Washington, 1993.
Zenelaj, Sheref S. *Kujtesë, Kavaja në vitet 1930-1940 simbas kujtimeve të bashkëkohësve*. Kavajë, 2000.
Zeqo, Moikom. "Durrësi mikpritës, gjithë populli pjesëmarrës". *Drita*, Tiranë, 14 Qershor 1987.
Zerdelia, Engjell. "Kongresi Arsimor i Tiranës dhe rëndësia e tij." *Telegraf*, Tiranë, 23 Korrik 2014.
Zhurnal Nr. 25. Me regji nga Xhanfize Keko, Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, 1962.
Zickel, Raymond E. Iwaskiw, Walter R. *Albania, a country study*. Library of Congress Federal Research Division, Washington, 1992.
Zojzi, Rrok, et al. *Arti Popullor në Shqipëri*. Akademia e Shkencave e Republikës popullore Socialiste të Shqipërisë, Tiranë, 1976.
Zojzi, Rrok. *Qilima shqiptarë*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1964.
Филимонова, Вера. "Экскурсия на частную керамическую фабрику в Кавае и мастер-класс у гончарного круга". *LiveJournal,* 19 Apr. 2015, https://verainalbania.livejournal.com/86628.html

83. Fëmijët e kopshtit “Shtëpia e Ëngjëjve" u japin formë baltës në punëtorinë e mbajtur në Kavajë më 16 Shkurt 2023.

fije balte

Rrugëtim me mjeshtëritë
tradicionale në Kavajë

Përgatitën për botim:
Irhan Jubica
Liridona Ura

Maj 2023

fije balte